**Republika e Kosovës**

**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**

**Kuvendi Komunal i Prishtinës - Skupština opštine Priština – Municipal Assembly of Prishtina**

T R A N S K R I P T

# Seancë e jashtëzakonshme e Kuvendit të Kryeqytetit

# Propozimvendimi për miratimin e buxhetit për vitin 2024

shqip.ai

Prishtinë

e enjte, 14 Shtator 2023

# Procesverbali

**FOLËSI_08** **01:49**
Përshëndetje për të gjithë!
I nderuar zoti kryetar Përparim Rama, nënkryetare Sahatçiu, nënkryetar Zogaj, të nderuar drejtorë, të nderuar këshilltarë komunalë, media të pranishme dhe qytetarët e kryeqytetit që po e përcjellin live këtë ngjarje.
Sot kemi thirrur mbledhjen e jashtëzakonshme të Kuvendit të kryeqytetit, e cila është thirrur në pajtim me nenin katërdhjetë e katër të Ligjit për vetëqeverisje lokale.
ë së pari duhet të bëjmë verifikimin e anëtarëve nga shërbimi i Kuvendit, se a kemi kuorum për të vazhduar tutje.
Atëherë konstatojmë se prezent janë njëzet e gjashtë kuvendarë dhe kemi kuorum të vazhdojmë tutje.
Për këtë seancë, siç e thashë edhe më herët, është parapa ky rendi i ditës: Propozim-vendimi për miratimin e Buxhetit të Komunës së Prishtinës për vitin dy mijë e njëzet e katër.
Nëse nëse ka diskutim tjetër lidhur me këtë temë, atëherë lus të pranishmi të reflektojnë.
Nëse jo, do të fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës dhe të vetmen.
Andaj, ë propozim-vendimi për miratimin e Buxhetit të Komunës së Prishtinës për vitin dy mijë e njëzet e katër dhe fjalën hyrëse, sikurse edhe arsyeshmërinë e kësaj pike doja do drejtoreshës fjalën.
Zonjushë Valbona Makolli.
Apo okej, atëherë fjalën së pari e merr kryetari Përparim Rama.
Nuk ë nuk ka nevojë, nuk ka nevojë.

**FOLËSI_20** **10:08**
I nderuar kryesues Bajqinovci, Të nderuar asamblistë,ë të nderuar ë nënkryetare Sahatçiu, nënkryetar Zogaj, të nderuar drejtorë, shumë të dashur qytetarë të kryeqytetit, të nderuar media, zonja dhe zotëri.
Kam kënaqësi në veçantë që sot para jush të prezantojmë Buxhetin e Kryeqytetit për vitin dy mijë e njëzet e katër.
Ju me siguri së tashme e keni lexuar dokumentin e buxhetit për këtë vit dy mijë e njëzet e katër, të cilin e keni parë e keni para vetit dhe i krijuar opinionet dhe qëndrimet tuaja të respektuara lidhur me këtë buxhet.
Unë sot do të prezantoj para jush e nderuar Asamble dhe përpara qytetarëve të kryeqytetit një përmbledhje të përpjekjeve dhe punës serioze të të gjithë drejtorëve këtu të pranishëm por edhe palëve tjera me interes në përgatitjen e këtij buxheti.
Drejtoritë tona kanë punuar palodhshëm nën udhëheqjen e Drejtorisë së Financave, prandaj një falënderim i madh drejtoreshës Valbona për një punë fenomenale që e ka ba.
Jam për përkujdesur që kërkesat dhe nevojat e të gjithë ë pjesëmarrësve në procesin buxhetor të bashkërendohen dhe të harmonizohen mirë.
Kjo punë është bërë me qëllim që të përgatitet një buxhet i balancuar që adreson kërkesat e qytetarëve dhe që është në përputhshmëri me platformën të cilën ne e kemi prezantuar në vazhdimësi.
Hartimi i buxhetit paraqet një ndër punët më sfiduese për ne si administratë dhe një gjë e tillë është e kuptueshme për faktin se nevojat e qytetarëve të kryeqytetit dhe dëshirat për të bërë më shumë për Prishtinën janë më të mëdha sesa mundësitë që i kemi në dispozicion.
Dhe në këtë drejtim ky buxhet është hartuar në mënyrë demokratike përmes konsultimeve publike me shumë palë të interesit.
Një pjesë e buxhetit është bërë edhe me konceptin e buxhetimit me pjesëmarrje të qytetarëve, ku qytetarët kanë propozuar dhe votuar për projekte që do të futen në buxhet.
Kemi konsultuar sektorin e arsimit, kemi konsultuar sektorin e shëndetësisë, kemi konsultuar sektorin e sportit, kemi konsultuar qytetarët në përgjithësi dhe kemi konsultuar po ashtu edhe ju të dashur juve të dashur asambleistë si përfaqësues legjitim të qytetarëve të kryeqytetit.
E tani ju prezantoj disa nga projektet kryesore të buxhetit dy mijë e njëzet e katër.
Buxheti i vitit dy mijë e njëzet e katër i kryeqytetit do të jetë njëqind e njëzet e tre milionë e shtatëqind mijë

euro, pra prej rreth njëzet milionë euro më i lartë se i vitit të kaluar, mirëpo prapë për fat të keq edhe ky buxhet është i bazuar në censusin e vitit dy mijë e njëmbëdhjetë, pra kuë kryeqyteti thuhet që ka vetëm njëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë banorë, ndërsa në bazë të ë analizave ë dhe matjeve dhe një prezantimi të World Bank të Bankës Botërore, supozohet që në kryeqytet janë më shumë se katërqind e pesëdhjetë mijë qytetarë.
Pra, edhe këto janë disa nga sfidat me të cilat ne përpiqemi si administratë, mirëpo përkundër kësaj ë ju uroj prapë për një punë fantastike që jemi duke ba së bashku.
ë buxheti i vitit dy mijë e njëzet e katër është buxhet i projekteve të mëdha kapitale, të cilat ë kanë qenë premtimet tona qysh prej ditës së parë të punës sime në kryeqytet.
Pra, do të jetë një buxhet i transformimit, një buxhet i transformimit të madh të kryeqytetit, ku rreth dyzet pikë pesë milionë euro janë të orientuara në investime kapitale.
Rreth dy milionë euro për parqet e Prishtinës dhe mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbërta, mbi gjashtë milionë euro për transportin publik, pa përfshirë këtu edhe blerjen e tridhjetë autobusave shtesë, afërsisht pesë milionë euro për menaxhimin e mbeturinave, një rritje e konsiderueshme të kësaj radhe, siç e dimë Vazhdojmë të kemi sfiduese çështjen e mbeturinave, për këtë arsye edhe ka qenë shumë me rëndësi të madhe që ne ta ngrisim buxhetin dhe ta zgjidhim këtë problem njëherë e përgjithmonë.
Mbi katër milionë euro për fillimin e ndërtimit të një projekti madhor, pra në të nënkalimit në rrugën Agim Ramadani, ky projekt do të mundësojë që të ndërlidhet sheshi Nëna të Rezë me tregun e gjelbër.
e po ashtu edhe me xhamitë e hamame.
Pra, të fillojmë transformimin e kryeqytetit të zonës së vjetër, ashtu siç edhe kemi premtuar.
Mbi shtatë milionë euro për vazhdimin e ndërtimit të rrugës Xhim Xhema.
Rruga Xhim Xhema është duke vazhdu ndërtimi i saj me një intensitet fantastik, mund me them lirisht më i mirë se të gjitha projektet tjera.
ë edhe puna e këtij projekti madhor do të vazhdojë, për këtë arsye edhe kemi një buxhet të konsiderueshëm të ndërlidhur me këtë ë projekt të madh, që po them përveç është një rrugë e re, është edhe një ë ashtu hapësinë për njëzet mijë banorë shtesë, e bën ndërlidhjen e lagjes Kalabria me Prishtinën e Re, ë po ashtu i ndihmon edhe trafikut, pra është një ë projekti më i madh në historikun e kryeqytetit.
Mbi dy milionë euro për përfundimin e ndërtimit të unazes qendër nga Rrokuzina deri tek rrethi i Lakrishtes, edhe ky është një projekt tepër me interes për kryeqytetin, për arsye se edhe kjo e bën atë pjesën e vet të ë ndihmës rreth trafikut në kryeqytet.
Mbi dy milionë euro ë po ashtu për rivitalizimin e tulltores, edhe ky është një projekt të cilinPrej fillimit kemi fillu transformimin e tij, ka qenë një vend i mbeturinave, ndërsa sot është një vend i artit, i kulturës, i workshopave të ndryshëm, një vend që është transformuar dhe tash krijon hapësina shtesë për të rinjtë tanë, për qytetarët tanë.
ë e këtë po e vazhdojmë, pra transformimin e tij edhe me një buxhet shtesë, tash dy milionë euro për rivitalizim të tij.
Kemi plane ë shumë interesante që aty të jetë jo vetëm arte dhe kulturë, por edhe teknologji ë që do t'ju ndihmojë rinisë tonë ë për të ë për të tashmen edhe të ardhmen.
Mbi dy milionë euro kontribut direkt i kryeqytetit në ndërtimin e sallës koncertale dhe Muzeut të Arteve.
Isha ë në Japoni edhe zoti Gengo Kuma, arkitekt i mirënjohur botëror, e prezantoi projektin.
Patëm diskutime shumë konstruktive dhe bëmë disa ndryshime dhe kemi tash një projekt ikonë, pra një ikonë të re të kryeqytetit, ë i cili ë në aspektin e projektimit, domethënë jemi në në ë dinamikën të cilën e kemi prezantuar dhe jemi marrë vesh me zotin Kuma.
E në anën tjetër, po ashtu jemi në diskutime të ë njëpasnjëshme me komunitetin evropian që nëpërmjet fondeve IPAK-jo të financohet dhe të fillojmë ndërtimin në prill të vitit të ardhshëm.
Rreth katër milionë euro, po ashtu për fillimin e ndërtimit të arenës multifunksionale të Sportit dhe Qendrës Olimpike në Bërnicë, e tash me lajmin fantastik që e kemi që Prishtina do të jetë nikoqiri e lojërave mesdhetare olimpikeë kjo është më se rëndësishme.
Po të them, ne këtë e kemi filluar qysh para gjashtë muajsh ë masterplanin, e po ashtu tash edhe buxhetimin për transformimin e kësaj e kësaj ë pjese.
mbi një milion euro për ndërtimin e thertores së kryeqytetit, e para ë në historinë e këtij ë kryeqyteti; rreth pesë milionë euro subvencione për kategori të ndryshme të shoqërisë, për bujqësi, për shëndetësi, për kulturë, për arsim e sport, po ashtu edhe për mirëqenie sociale; rreth katër milionë euro investime për vazhdimin e ndërtimit të shkollave dhe çerdheve në Prishtinë;një pikë pesë milionë euro për fillimin e ndërtimit të spitalit të kryeqytetit, po ashtu edhe fillimin e ndërtimit të Bulevardit Xhorxh Bush, i cili tashmë vetëm se po përdoret shumë e më shumë edhe ka fillu transformimin edhe çlirimin e hapësirave publike për qytetarët tanë.

Dhe investime të shumta në rrugë në zonat rurale, pra transformimi i ë Prishtinës në zonat rurale është më se i rëndësishëm ë për arsye të ndryshme, numër një shëndeti, numër dy turizmi, aspekti ë i atraksioneve të ndryshme që mundet me u zhvillu, e po ashtu edhe ndihma e familjeve që jetojnë në këto zonat rurale që me të vërtetë t'ju mundësojmë ë të zhvillimin e turizmit malor, agroturizmit e tjera që do ta bëjëPrishtinën një vend të përjetimeve pozitive të mrekullueshme, po them jo vetëm për qytetarët tanë, por edhe për shumë turistë që tanimë e zgjedhin Prishtinën si vend ë interesant turistik, vend të përjetimeve.
Pra, këto janë vetëm disa nga projektet e përzgjedhura, sepse lista e plotë e projekteve është e gjatë dhe atë e keni të gjithë para vetes.
Prandaj, të nderuar asamblistë, asamblistë, ju ftoj të mbështetni këtë buxhet të transformimit të kryeqytetit për të mirën e të gjithë qytetarëve të Prishtinës.
Ju falënderoj shumë!
Faleminderit!

**FOLËSI_08** **00:04**
Faleminderit, kryetar Rama!
Andaj, vazhdojmë me drejtoreshën Valbona.

**FOLËSI_19** **02:50**
Përshëndetje!
Faleminderit, kryesues!
Ë rreth përgatitjes së buxhetit për vitin dy mijë e njëzet e katër, më lejoni të falënderoj përzemërsisht që Drejtorinë e Financave ka ba më të lehtë punimin ekëtij buxheti, duke i falënderuar kështu radhazi kryetarin Rama, nënkryetarët, drejtorët e drejtorive, po ashtu zyrën ligjore, zyrën e Kuvendit bashkë me kryesuesin, po ashtu edhe sektorët e tjerë të cilët janë të ndërlidhur me përgatitjen e Propozim-buxhetit të vitit dy mijë e njëzet e katër.
Po ashtu, ju njoftoj se ë para përgatitjes dhe për me pranimin e e qarkoreve nga Ministria e Financave qarkorene parë dhe qarkoren e dytë, ku janë përcaktuar edhe kufijtë buxhetor për buxhetet komunale edhe ashtu nivelit qendror, ne pa si kemi pranuar qarkoren e kemi mbajtur pesë dëgjime buxhetore për qytetarët. në mujin korrik, po ashtu janë mbajtë edhe pesë dëgjime të tjera ë përmes ë USAID-it dhe stafit i cili është i përcaktuar nga kryeqyteti, ku kanë ba edhe pesë dëgjime të tjera nëpër lagje të ndryshme, ku ka rezultuar me pesë projekte të cilat ata siç e ceki kryetari i kanë votuar dhe i kanë propozuar dhe janë futur në buxhetin e dymijëenjëzet e tretës.
Buxheti për vitin dy mijë e njëzet e katër për kryeqytetin është njëzet e tre milionë e shtatëqind mijë euro dhe atë Ligji përkushte përfshirë në këtë vlerë Ligji për kryeqytetin në vlerën prej shtatëmbëdhjetë milionë e tetëdhjetë mijë, granti specifik për arsimin njëzet e gjashtë milion pesëqind e pesë mijë dhe granti specifik për shëndetësinë dhjetë milionë e katërqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e njëzet euro.
Ky buxhet sikur edhe pagat dhe mëditjet për vitin dy mijë e njëzet e katër është katërdhjetë milionë, katërqind e nëntëdhjetë e nëntë, gjashtëqind e shtatëdhjetë e katër mijë euro.
Mallat e shërbimeve njëzet e tetë milionë e dyqind mijë, komunalitë tre milionë dhe subvencionet dhe transferet pesë milionë e pesëqind dhe investimet kapitale katërdhjetë e gjashtë milionë e pesëqind, treqind e njëzet e pesë.
Domethënë, dhe diferenca e cila është bërë në krahasim me vitin dy mijë e njëzet e tre, reflektim ka pasur te kategoria e pagave dhe mëditjeve, për shkak të hyrjes në fuqi të Ligjit për paga, ku vetëm dallimi në faktorën vjetore të pagave dhe mëditjeve prej tridhjetë e dy milionë e nëntëqind e tridhjetë e pesë në vitin dy mijë e njëzet e katër do të jetë katërdhjetë milionë e katërqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë euro.
ë tjerat po ju la kohën juve, meqenëse kryetari i përshtuajti dhe ne sot jemi këtu për me ju dëgju edhe juve, edhe pse një ditë prej ideve e kena pasur që Kuvendi Komunal t'i paraqet kërkesat, kanë qenë humbur shumë i vogël, mirëpo ne prapë jemi këtu në bashkëpunim me juve për me ju dëgju prapë rreth propozim-buxhetit të vitit dy mijë e njëzet e tre.
Faleminderit njëzet e katër!
Faleminderit shumë!

**FOLËSI_08** **00:14**
Faleminderit, drejtoreshë!

Atëherë hapim diskutimin në lidhje me me temën e ditës së sotme.
Në emër të Grupit Parlamentar nga Lidhja Demokratike e Kosovës fjalën e ka Donjeta Dragusha.

**FOLËSI_16** **04:19**

Faleminderit, kryesues!
I nderuar kryetar Rama, të nderuar nënkryetarë, zotëri Zogaj, zonja Sahatçiu, të nderuar drejtorë, të nderuar kolegë asableistë, përfaqësues të mediave, të nderuar qytetarë të Prishtinës, përshëndetje për gjithë.
Sot po flasim për buxhetin e kryeqytetit për vitin dy mijë e njëzet e katër dhe siç e dimë është dokumenti më i rëndësishëm i komunës dhe rrjedhimisht edhe përgatitja e tij është procesi kryesor që definon kahjen të cilën kryetari Rama po i jep zhvillimit të kryeqytetit.
Andaj, për gjithë këtë proces e falënderoj kryetarin, drejtoreshën e financave dhe të gjithë drejtorët për përgatitjen dhe paraqitjen para neve të buxhetit për vitin dy mijë e njëzet e katërBuxheti i vitit dy mijë e njëzet e katër pritet të jetë rreth njëqind e njëzet e tre pikë shtatë milionë euro, prej tyre rreth tridhjetë e tetë pikë shtatë milionë janë parashikuartë hyrat vetanake rreth shtatëmbëdhjetë milionë granti nga Ligji për kryeqytetin dhe pjesa tjetër nga grantet qeveritare.
Është shumë e rëndësishme që me këtë Buxhet është bërë rritja e parashikimeve të të hyrave vetanake dhe shpenzimeve kapitale krahasuar me vitet e kaluara.
Në tërësi të planifikimit, këtë vit si asnjëherë tjetër kemi të planifikuara shumë projekte të mëdha, të cilat vërtet do ta transformojnë kryeqytetin.
shohim se kryetari Rama dhe ekipi i tij janë kujdesur që të kemi investime kapitale për projektet e mëdha në secilën drejtori komunale, projektet këto që do të prekin secilën fushë të jetës së qytetarëve të Prishtinës, e kjo do të thotë që Prishtina është për të gjithë.
Pra, Prishtina duhet të ketë spitalin e saj dhe për këtë janë planifikuar rreth një pikë pesë milionë euro vetëm vitin e ardhshëm.
Pa hyrë në detaje për secilin projekt në shumat e planifikuara, po përmendi vetëm disa.
ndërtimi i rrugës A; nënkalimi për vetura në rrugën Agim Ramadani; ndërtimi i unazës Qendër dhe lidhja me lagjen Arbëria; ndërtimi i ishullit urban Arbëri - Pallati i Rinisë; ndarja zonale për mirëmbajtjen e rrugëve në tërë territorin e Prishtinës; tri shkolla të reja, duke përfshirë edhe Liceun artistik të premtuara nga kryetari Rama; ndërtimi dhe renovimi i objekteve të çerdheve; rritja e Buxhetit për Transportin Publik;janë të gjitha këto projekte që do ta bëjnë Prishtinën praktike dhe do ta lehtësojnë jetën e qytetarëve tonë, siç e dimë ky ishte dhe mbetet qëllimi kryesor i kryetarit Rama dhe kësaj qeverisje.
Pastaj, kryetari Rama na premtoi Prishtinën e përjetimeve dhe pikërisht ndërtimi i sallës koncertale, rikonstrukturimi i Pllatosë në lagjen Dardania, ndërtimi i arenës multifunksionale të sportit në Bërnicë, janë vetëm disa nga projektet e planifikuara në kulturë dhe sport, të cilat vërtet do ta bëjnë Prishtinën e përjetimeve, ndërtimi i tregjeve të gjelbërta, ndërtimi i parqeve në kalabri, bregun e diellit dhe kodrën e trimave, rritja e buxhetit për menaxhimin e mbeturinave, ndërtimi dhe funksionalizimi i kontinuerëve nëntokësor dhe gjysmë nëntokësor, janë vetëm disa projekte të cilat do ta bëjmë Prishtinën më të pastër dhe më të gjelbër, si NMK që ka qenë një ndër tri shtyllat kryesore të programit tonë.
Përveç këtyre kemi edhe shumë projekte përmes bashkëfinancimit, të cilat këtë vit i kishim të inkorporuara edhe në tabelat e kornizës afatmesme buxhetore.
Sigurisht këto projekte vijnë si rezultat i një bashkëpunimi të shkëlqyer të kryeqytetit me institucionet financuese.
Prandaj, ne si grup i Asambleistëve të LDK-së jemi të lumtur që çdo ditë e më tepër po jetësohen projektet dhe programi i premtuar nga LDK me kryetarin Rama për kryeqytetin tonë dhe këtë qytetarët po e vërejnë më së miri çdo ditë.
Sigurisht që e përkrahim dhe urojmë që puna në të gjitha projektet të vijojë marrë dhe mirë pa u penguar nga askush.
Faleminderit!

**FOLËSI_08** **00:27**

Faleminderit, zonjusha Dragusha!
Atëherë, vazhdojmë diskutimin me Grupin Parlamentar nga Partia Demokratike e Kosovës.
Atëherë fjalën e ka zoti Leutrim Retkoceri.

**FOLËSI_03** **06:53**

Faleminderit, kryesues!
Të dashur qytetarë të Prishtinës, I nderuari kryetar Rama, nënkryetare Sahatçiu, nënkryetar Zogaj, Drejtorë të nderuar, Kolegë asamblistë, Ne në këtë seancë jemi duke shqyrtuar dokumentin më të rëndësishëm të kryeqytetit, e ky është projektbuxheti për vitin dy mijë e njëzet e katër.
Në fillim të seancës, kjo seancë ë nuk po është e plotë edhe pa përfaqësimin e opozitës, për të cilët mendoj që është roli i dëmshëm për kryeqytetin, sepse hekja dorë nga besimi i qytetarëve ë është mospërfaqësim dhe pranim edhe i gabimeve të mundshme që mund t'i bëjë, qoftë ekzekutivi, qoftë ky Kuvend pa pjesëmarrjen e tyre.
Ky duhet të jetë një mesazh i qartë edhe për qytetarët, se kënd ka zgjedhur në zgjedhjet e fundit që t'i përfaqësojnë ata që abstenojnë, tentojnë të bllokojnë dhe nuk marrin pjesë në seancën më të rëndësishme të Kuvendit, e që është buxheti për vitin dy mijë e njëzet e katër.
I nderuar kryetar, Ne ju dëgjuam me vëmendje gjatë prezantimit të ërezymesë së buxhetit.
Është një buxhet i rëndësishëm, është një buxhet ambicioz i cili fokusohet në projekte të rëndësishme, ato që u përmendën, qoftë në investime kapitale, në ndërtimin ë në një qytet më të pastër, në një qytet me mobilitet, por çka është e rëndësishme është që gjatë zhvillimit të fazaveËshtë më se e nevojshme që ne të kemi edhe një diskutim nga shumica e drejtorëve për projektet e tyre të cilët i kam vendosur në Buxhet, ë që t'i arsyetojnë ato para qytetarëve, duke pasë parasysh se sot gjendemi në një seancë të jashtëzakonshme të votimit të Buxhetit.
Kjo me idenë më të mirë që ky Buxhet të jetë sa më transparent, më i hapur,dhe të dëgjojnë qytetarët e kryeqytetit se cilat projekte do të zhvillohen në vitin dy mijë e njëzet e katër ë me këtë Buxhet, cili projekt në detaje.
Ë është me rëndësi të ceket, unë e dëgjova edhe drejtoreshën në arsyetimin që e bëri në raport me procesin e zhvillimit të të gjitha fazave për ndërtimin e Buxhetit.
dhe unë mendoj që nga të gjitha ka qenë ë e mirëseardhur sikur ë edhe Kuvendi ta kishte kohën e mjaftueshme bazuar në ligj prej një muaji që diskutimet me qytetarë t'i zhvillojë edhe Kuvendi Komunal, në mënyrë që të informohen të gjithë qytetarët.
Ndaj respekt për të gjithë angazhimin që është bërë me ato pesë dëgjimet publike, por mendoj se buxheti nësa më i sqaruar se me sa më shumë diskutime do të jetë më i frytshëm, do të jetë më llogaridhënës edhe më transparent para qytetarëve të kryeqytetit.
Ë si partnerë të koalicionit, të cilët ë jemi në ekzekutiv me pesë drejtori, Drejtorinë e Arsimit, Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Drejtorinë e Bujqësisë, Kulturës, Rinisë dhe Sportit,Për ne ky buxhet reflekton prioritetet në shërbime dhe zhvillim, gati gjashtëdhjetë për qind e buxhetit është i shpërndarë në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve që mbulohen nga këto drejtori.
Përderisa kjo shifër është e lartë, është një përgjegjësi e madhe që kemi në fokus shërbimet e mobilitetit të qëndrueshëm, investimin dhe menaxhimin më të mirë të mbeturinave, mbulueshmëri më të madhe në ndryshimin smart, sinjalistik të përmirësuar, shujta, mjeshtër në shkolla e kopshtar, digjitalizim, strategji të parë të agroturizmit në zhvillim të fshatrave tona, kopshteve të para urbane e shitja online të produkteve bujqësore.
Mendoj që buxheti i vitit dy mijë e njëzet e katërdo të realizoj të gjitha të gjitha projektet që janë të ë shfaqura dhe që i pamë në në në televizion, por ne presim që edhe nga drejtorët të kemi njësqarim se këto projekte a do të jenë të realizueshme gjatë vitit dy mijë e njëzet e katër, marrë parasysh praktikat e buxheteve të mëparshme që suficidi shpeshherë i ka kthyer në projekte të pambuluara.
Kjo do të jetë në një mënyrë e mirë që edhe ne si asamblesë të japim kontributin tonë në këto projekte, të informohemi më mirë në detaje dhe të shohim aspektin kohor se cilat do të jenë prioritetet e para, cilat do të fillojnë të realizohen qysh në fillim të vitit dhe sa do të realizohen deri në përfundim të vitit dy mijë e njëzet e katër.
Unë i kam parasysh që edhe granti qeveritar ë zonja ë drejtoreshëë granti qeveritar për Komunën e Prishtinës nuk mund të jetë edhe ai më i drejti, sepse ndahet për njëqind e tetëdhjetë njëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë banorë, kurse kryeqyteti sot ka një numër shumë më të madh të banorëve.
Unë uroj që me këtë Buxhet të jetë granti që nuk do të vlerësohet më kështu në Buxhetin dy mijë e njëzet e pesë, me vetë faktin se shpresoj që niveli qendror do t'i realizojë dhe përmbushë detyrat e saj në regjistrimin e popullsisë e në një regjistrim të saktë të popullsisë, qytetarët në kryeqytet do të kalojnë apo të dyfishojnë këtë shifër që neve na paraqitet nga Ministria e Financave si grant qeveritar.
Kjo do të mundësojë që kryeqyteti të ketë mjetemë shumë në mënyrë që të përmbush më mirë përgjegjësinë para qytetarëve në realizimin e projekteve si kryeqytet për vitin dy mijë e njëzet e pesë ë e tutje.
Faleminderit, kryetar!

Faleminderit kolegë asamblesit!
Unë tani më pres sigurisht edhe nga drejtorët që në bazë të renditjes të bëjnë edhe prezantimet e projekteve të tyre.
Sot e kemi ndamë këtë ditë vetëm për buxhet.
Faleminderit shumë!

**FOLËSI_08** **00:11**
Faleminderit kolegë!
Ë vazhdojmë diskutimin.
Atëherë fjalën po e dha zotit Sami Boroci.

**FOLËSI_26** **03:47**
Faleminderit!
Faleminderit kryesues!
Përshëndetje kryetarë, nënkryetarë, drejtorë, kolegë asamblistë, media dhe mysafirë.
Ë realisht kjo seancë do të duhej edhe në fakt është seanca më e rëndësishme e vitit.
ë sepse këtu po planifikojmë një vit ë një vit të të ardhshëm të qeverisjes edhe ë po miratojmë një buxhet që ë parashihet me qenë buxhet që ka me transformu qytetin, ashtu qysh edhe ka qenë ë plani, ashtu qysh edhe ë në fakt kauza me të cilën e keni fitu zgjedhjet si ë si qeverisë edhe si koalicion.
Ë tu e pasë strukturën e buxhetit ë njëqind e njëzet e dy milion ë afërsisht është njëqind e njëzet e trePo duket goxha buxhet ambicioz, është buxheti më i madh naj herë i Komunës së Prishtinës, ë mirëpo unë shpresoj që ky buxhet të ë jetë i planifikuar mirë fillimisht, sepse ë kemi pasë shumë me vitet e tana, apo kemi ë keqplanifikim, ndoshta edhe kjo po reflekton mandej në mos ë mosrealizim të buxhetit, ose realizim shumë të ulët të buxhetit, edhe bartje masive në në vitet në vitet tjera.
Kështu që urrej që fillimisht këto projekte t'i keni planifiku mirë, të keni bo analizat dhe studime të nevojshme, e përmendi edhe parafolës i Leutrimi, ndoshta do të ishte mirë që pas diskutimit këtu në gjeneral që e kemi si përfaqësues të grupeve, do të ishte mirë që të kalohet ndoshta pak edhe në detaje, sepse e kemi vetëm këtë pikë edhe nga drejtorët dhe t'i sfigojnë është edhe pak më shumë projektet dhe ndoshta mundem me mu lëshu haladrin e diskutime ë kësë unë mirëpres ë një ë miratim të një buxheti kaq të madh dhe kaq ambicioz, po e shoh që ligji i pagave ka reflektu në kam duket rreth dhjetë milionë euro janë ma shumë te paga edhe me ditje, ë është normale kjo, sepse ë jemi dëshmitarë që veç ë ligji ka hyrë në fuqi.
ë po diçka tjetër që ë po i shoh strukturën e buxhetit është e njëjtë, drejtoresha e financave e di që e bën një punë shumë të madhe dhe është ë ka një aftësi shumë të madhe dhe një bashkëpunim shumë të madh ë me Kuvendin.
Ë ka mirëpo ka tituj se a e din nëse i lexoni që për herë të parë, kështu nuk e ndoshta kanëherë nuk më rrinë me i ë me e ditë saktë për çfarë projekti është fjala edhe ndoshta do të duhej që tëë diçka tjetër ë nuk kam.
Mendoj që ë uroj në fakt që ky buxhet mos me u ë mos me u ë bo peng i një ë i një kthimi mbrapa nga ë niveli qendror.
sepse ky Kuvend tashmë e ka një ë shumicë të ligjshme edhe këto vendime duhet mu trajtu si vendime të ligjshme.
E di që është edhe një procedurë duke u zhvillu në Gjykatë, mirëpo është ë thjesht është vullneti i qytetarëve është ë ka një ligjshmëri secili vendim që merret tu edhe urrej që buxheti ë si ndoshta vendimi më i rëndësishëm që e marrim brenda vitit ë mos mu prolongu, mos mu mos mu kthy mbrapa dhe mos me u lujtë pingpong me të.
Ë nuk po du me u lëshu ë në drejtori, ë po shihet që është një buxhet në investime kapitale, ë po shihet që edhe Drejtoria e Arsimit ë ka planifiku digjitalizim qysh e ka pasë gojën ë plot në fushatë zgjedhore që është shumë e rëndësishme dhe mirëpres shumë, ë mirëpo unë veç shpresoj që përnjëmendta kemi planifiku buxhetin mirë dhe ta realizojmë, sepse ë ndoshta beteja jonë kryesore ka me qenë realizimi i buxhetit përmes implementimit të projekteve, sepse vitet po shkojnë edhe përnjëmijë a Prishtina duhet mu transformu ashtu qysh keni premtu.
Faleminderit qëndru!

**FOLËSI_08** **00:29**

Faleminderit zoti Boroci!
Vazhdojmë diskutimet.
Nëse ka të tjerë.
Nëse nuk ka, atëherë nëse jeni dakord, do vazhdojmë me prezantimin ë e secilës pjesë nga secila drejtori apo drejtor që janë të pranishëm, sadopak me arsyetu atë pjesën e buxhetit.
Po sigurisht ë drejtori Izet Sadiku.

**FOLËSI_05** **02:05**
Faleminderit shumë!
Të nderuar kryetarë, Të nderuar nënkryetarë, Drejtorë, Asambleistë, Faleminderit!
Unë në pika të shkurtra do të paraqes projektet që janë të ë ndodhë në fushën e shëndetësisë.
Ju e dini që ndryshimet që kemi ba me qeverisjen Rama në Prishtinë në fushën e shëndetësisë janë të prekshme, domethënë në këtë në fakt kemi edhe feedback prej qytetarëve, domethënë hulumtimit të ndryshme që po bëjnë, shëndet shërbimi shëndetësorkëna që qytetarët, dy projekte të cilat janë shërbime kapitale që unë po du me i forcu këtu, ne kemi rritë shërbimin për nenin dhjetë mijë në vitin e ardhshëm, ky është projekt i ministrisë, është grant i ministrisë dhe për shërbime paliative që do të jenë shërbim shtesë te shërbimi shëndetësor kronik që e kem tash me qytetarë.
Përveç renovimeve,Ajo që du me u ndalë, e që është besoj projekti ma kapital, ma i rëndësishëm në shëndetësinë e Prishtinës, edhe të Kosovës besoj komplet, është ndërtimi fillimi i ndërtimit citar të Prishtinës.
Ka qenë premtim që njëzet vjet, njëzet e katër vjet pas luftës dhe nuk është ba realitet, ne jemi kryetari në Rama e bëjmë e bëjmë dometë realitet.
Ne faktikisht kemi ndarë së fjetë buxhet, por ju e dini që është ba një projekt ndërkombëtar, një kompani ndërkombëtar është ba projektin dizajnin, ende s'e ka dorëzu dovan ë raportin.
Mendojmë që deri në fund tetori do të jetë raporti final për dizajnin në Spitalin të Prishtinës.
Ne e kemi ndarë pronë nëpër këtë spital, e kemi edhe një milion e treqind që janë për këtë vit dheNe mendojmë me fillu ndërtimin e spitalit, sigurisht shuma është simbolike, por duke pasë parasysh që do të jetë një tender ndërkombëtar, mendojmë që mjafton për me fillu punët për ndërtimin e spitalit.
Prandaj, ne e kemi ba të gjitha përgatitjet këto dy vite domet dhjetë viti, ë dy mijë e njëzet e katër do të jetë vit i fillimit të ndërtimit të spitalit të kryeqytetit.
faktikisht këto janë projektet kryesore, nuk po du me u ndarë ma shumë, që ose ka dikush pastaj me pyetur se ndonjë sharim shtesë të marrë në kjo.
Do të vazhdojnë renovimet, infrastrukturës, mbajtësi mjekësore, të cilat besoj edhe sot janë të mirëfundizuara institucionet dhe renovimet që gjysa e institucioneve të Mjekësisë Familjare në Prishtinë janë të renovuara.
Faleminderit shumë!

**FOLËSI_08** **00:09**
Faleminderit, drejtor!
Atëherë, para se me dalë tek drejtoritë tjera, nëse kemi diskutim lidhur me pjesën e shëndetësisë, po zoti Boroci.

**FOLËSI_26** **00:37**
Faleminderit, kryesues!
Ë faleminderit, drejtor i Shëndetësisë për prezantimin!
E kam veç një pyetje që po du me qartësu pakëqet pjesën në spital, ndërtimin e Spitalit të Prishtinës. Konkretisht, ë rolin e Ministrisë së Shëndetësisë ë a ka me ndërtu prej Komunës të Prishtinës a u qartësu kjo mjaftueshëm, a ka me pasë pengesë ose a e kemi në këtë fazë pengesë ose bllokadë të nivelit qendror ose të Ministrisë së Shëndetësisë apo domethënë, ka me pasë ndoshtame na sqaru.
Faleminderit shumë!

**FOLËSI_08** **00:35**
Atëherë kërkojmë edhe pyetje tjera lidhur me diskutimin nga drejtori i Drejtorisë së Shëndetësisë.

Nëse keni edhe diskutime tjera çka të bëjë, përndryshe drejtori do merr fjalën.
kërkoj ndjesë se monitori është i zëmë dhe nuk po vazhdon, ju lutem!
Atëherë, lus regjinë të jep fjalën.

**FOLËSI_10** **00:45**
Ë përshëndetje të nderuar kryetarë, nënkryetare Sahatçiu, ë nënkryetar Zogaj, ë ju drejtorë të nderuar dhe ju kolegë të Asamblesë.
Ë projekti për ëProjekti për ë kujdesin e nënës dhe fëmijës, siç e ceku drejtori për shëndetësi, ë është një projekt shumë i mirëpritur që kemi pritur me vite të tëna, ë por po më intereson prej drejtorit me ditë a ka me pasë ë sa ka me pasë punëtorë, shtesë, mjekë, infermierë, si ku si ka me u realizu ky dhe sa mjekë infermierë kanë me qenë për për lagje për banorë, sa është e planifikume me me këtë buxhet?
Faleminderit shumë!

**FOLËSI_08** **00:32**
Faleminderit!
Ë lus edhe regjinë, nëse ka anëtarë tjerë që dojnë të diskutojnë, vetëm me ngritje dore ë jepni mundësinë për të folur.
Faleminderit!
Atëherë, pasi që nuk kemi diskutim tjetër, lidhim me këtë temë.
Po tash do jep do jep përgjigje drejtori.
Faleminderit për sugjerimin edhe për... Faleminderit!

**FOLËSI_05** **03:37**
Faleminderit!
Për pyetje të së pari, spitali i Prishtinës do të jetë në zonën e Prishtinës e Re, por që zonën kadastrale domethanë e figuron në komunë si zonën e Çakllavicës, si domethënë në qoftë se nxeh një listë posedues, është zonë e Çakllavicë, por është Prishtina e Re që është mbi pallatin e drejtësisë të Trafoje që shkojmë, rruga që shkon për te atje në Hajvali te te Inspektorati Policor dhe anën e majit është hapësira, diku mbi katërFaleminderit Sami, po sigurisht.
Ne kemi ba disa takime bashkë me kryetarin dhe Ministrinë e Shëndetësisë, kemi diskutu.
Nuk kemi pasë ndoshta ndonjë dakordim për mënyrën e financimin e përbashkët.
edhe ata kanë pasë nuk kanë pasë ndonjë qëndrim të saktë çka mendojnë ata konkret për spitalin.
Ne kemi tregu që spitali është e drejtë me ndërtu Prishtina.
Ne kemi pasë gatishmëri, disa herë kemi ba disa tryeza, takime që me qenë projekt i përbashkët, s'është interes qytarët e Prishtisë me pasë një spital edhe me dhanë mundësi që edhe Ministria e Shëndetësisë me kontribu, ende s'kemi pasë ndonjëë ofertë konkrete prej tyre, por unë besoj që ata kanë me përkrahë.
Spitali do të fillojë si ndërtim vetanak i Komunës së Prishtinës, por kryetari do ta bëjë një grup bashkë me mua që ne do të lobojmë edhe për donacione, duke pasë parasysh se do të jetë njëra prej investimeve ma të mëdha në shëndetësinë, por ne e nisim vetë spitalin.
Sigurisht që do të kërkojmë edhe përkrahjen e ministrisë, por edhe të donatorëve tjerë, në qoftë se ka me pasë.
Në qoftë se jo, unë mendoe vet.
E dyta, sa i përket projekti për nëntëdhjetë fëmijun, ne i kemi mbi pesëdhjetë trajnere të trajnuar për këtë program.
Ne e kemi fillu programin, i cili është në përkrahje edhe nga Ministria e Shëndetësisë, por ne i kemi diku një grant katërqind e pesëdhjetë mijë euro nga Ministria e Shëndetësisë, të cilin fatkeqësisht na nuk mund të shfrytëzojmë, për shembull se të jepet pare dhe s'mundësh me punësu njerëz.
dhe ky grant neve na nevojon vetëm për njerëz, për arsye se ju e dini që në mjekësinë primare në Prishtinë e përmendur kryetari, fatkeqësisht ne marrim numër për njëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë banorë marrin numrin e mjekëve dhe s'është grant numri i mjekëve ndarë sipas numrit të banorëve dhe kem njëqind mjekë familjarë dhe dyqind infermierë, a japim shërbime për katër, sigurisht për rreth të katërqind mijë banorë dhenda fillimi i një projekti ka qenë me shumë rrezik për ne, por ne e kemi fillu këtë projekt, ka shku shumë mirë, ka pasë shumë kënaqshmëri qytetarëve që janë tu marrë shërbimet, ajo që ka pasë hezitim që jemi tu punu në këtë vit është që kam pasë goxha hezitim qytetarët me e pranu shërbimin, s'kemi nevojë, ne po

punojmëme bisedu me familje sa më shumë që me u promovu ky ky shërbim dhe mendojmë që vitin e ardhshëm mjetet që i kemi, po them edhe një herë, me me kontraktu kompani që jepin këto shërbime, se s'mund me punësu njerëz apo kontraktimin e kompanive për rritjen e stafit mjekësor për këtë fushë dhe sigurisht i kemi diku një mijë e njëqind euro që është për shërbim paliativ, kemi me rritë shërbimin kronik me ba shërbim paliativ, sigurisht shërbimi paliativ është shërbim diçka i veçqë jepet për personat që janë në fazën terminale, jo për ata që kanë sëmundje kronike, por në fazën terminale, që aty përveç trajtimit për pacientë kemi nevojë me i trajtu edhe familjarët, se ata zakonisht ndihma e atyre qytetit, shpesh atyre personave që janë në fazën terminale është e nevojshme njëzet e katër orë dhe kanë nevojë kanë ecë edhe familjarët me ditë qysh me ia dhënë një ushqim, qysh me i rrotullu në shtrat dhe shërbimit pariativ që do të fillojë besëdhe duke pasë parasysh mungesën e institucioneve për kategorinë e tretë që për moshën e tretë që quhen, për ata që janë mbi gjashtëdhjetë e pesë, ne s'kemi spitalet Geriatrike, rritja e këtij shërbimi që kena ba me ardhjen tonë në pushtet kryetari Rama, ne besoj që e kemi kthy dinjitetin çdo qytetari i cili për të cilën e kemi obligim.
Ne e kemi obligim për çdo qytetari deri në minutën e fundit të jetës tina me ia ba dinjitesh me jetën dhe mendoj që ky shërbim e ka bë atë

**FOLËSI_08** **00:11**
Faleminderit, drejtor ë Sadiku!
Atëherë fjalën e merr kryetari Rama.

**FOLËSI_20** **02:38**
Zoti Borovci, desha me u ndërlidh në aspektin e spitalit të kryeqytetit.
Ë bisedat i kemi pasë, faktikisht kemi pasë më shumë se një takim me ministrin e Shëndetësisë, biseda pozitive, shumë të frytshme, ku edhe e kemi paraqitë mundësinëjo vetëm për spitalin e kryeqytetit, por një mundësi të zhvillimit edhe të spitalit të terciar për për të gjithë Kosovën.
Domethënë e kemi një mundësi të artë me bashkëpunu niveli qendror me nivelin lokal, me kriju spitalin e kryeqytetit, i cili faktikisht në bazë të ligjit të kryeqytetit edhe i cakt i takon kryeqytetit.
ë gjatë ndërtimit, pra ose përfundimit të spitalit të kryeqytetit, me ofru edhe shërbime terciare në një periudhë kohore tranzitore, ku ne e kemi ofru si një mundësi për me zhvillu spitalin terciar në Malësi të Gollakut, pra njëra ndër fshatrat ë e Gollakut, tash në masterplanin në planin zhvillimor komunal, të cilin jemi në përfundim.
me përzgjedh që atje me mujt me zhvillu ë shëndetësinë tersiare.
Pra, të gjitha hulumtimet, zhvillimet me ndodh sikurse ndodhin nëpër ë shtetet ë perëndimore.
Pra, ta kemi një një spital të dinjitetshëm, fantastik, tersiar në ë fshatrat e Gollakut, ndërsa spitali i kryeqytetit ë me u ofru shërbime qytetare të kryeqytetit ashtu si e meritojnë.
Kjo e lë një hapësinë shumë të madhe në qendër të kryeqytetit, ku tash është QKUK-ja.
Ë tash projekt-propozimet që janë rreth rivitalizimit të hapësinave të QKUK-së është shumë e vështirë, është tepër e vështirë.
ë edhe shërbimet e dini aty, për shkak për shkak të të infrastrukturës të stërvjetuar edhe jo të mirë ë janë nuk janë të nivelit të standardit që duhet.
Pra, kemi një mundësi fantastike ndoshta me involvu edhe sektorin privat, me hapat pjesë në qendër të Prishtinës për mundësi të partneritetit publiko-privat, ku nëpërmjet këtij partneritetit e krijojmë spitalin terciar në Malësinë e Gollakut.
po ashtu në të njëjtën kohë spitalin e kryeqytetit edhe kemi ndoshta edhe një park edhe një zhvillim fantastik në qendër të kryeqytetit që lidhet me ë rrugën Xhim Xhema.
Po kjo është ë ajo çka e kemi diskutu dhe shpresoj që ë do ta kemi një mundësi fantastike të bashkëpunimit me nivelin qendror me Ministrinë e Shëndetësisë.

**FOLËSI_08** **00:19**
Faleminderit, kryetar Rama!
Vazhdojmë diskutimet.
Nëse kemi diskutime në lidhje me me buxhetin nga Drejtoria e Shëndetësisë, nëse jo, atë e kërkoj nga drejtorët të cilët ë dëshirojnë, po, drejtoresha Besiana Mus Murati, Drejtoria e Arsimit.

**FOLËSI_17** **03:51**
Faleminderit shumë kryesues!
Atëherë përshëndetje për të gjithë, ë më vjen mirë që do ta diskutojmë ë buxhetin e arsimit ë në veçanti.
Ë buxheti gjithsej ë për vitin dy mijë e ë njëzet e katër në arsim do të jetë tridhjetë e dy milionë e dyqind e nëntëdhjetë mijë euro.
dhe i ndarë në kategoritë e pagave, mëditjeve, mallrave, shërbimeve, shërbi ë komunalitë, ë shpenzimet kapitale dhe subvencionet.
Ë më vjen mirë që po e reflektojmë Buxheti përkitazi me të gjitha prioritetet tona që i kemi pasë, edhe si ë Prishtina na bashkon si ekip i PDK-së në kryeqytet.
ë Samiu e përmendi me të drejtë projektin e digjitalizimit, a është veç një prej shumë projekteve të cilat ë ne i kemi pasë ë premtime elektorale dhe të cilat ë po mundohemi të t'i përmbahemi ë në përgjegjësi.
Buxheti për mallra dhe shërbime do të jetë diku rreth tre milionë euro.
dhe i kisha veçu disa prej projekteve të cilat i kemi pasë edhe pjesë të projektit Prishtina na bashkon.
Ë projekti i digjitalizimit i kemi ndarë njëqind e gjashtëdhjetë mijë ë euro për të bërë digjitalizimin e një ë e sistemit arsimor në Komunën e Prishtinës.
ë kemi do kemi bërë për herë të parë kemi aloku mjete për planin për siguri në shkolla, që mendoj që është një ë lajm shumë i mirë dhe shumë pozitiv, sepse me të vërtetë ka shumë nevojë, sepse dhuna në shkolla dhe në institucione ë arsimore është rritë, sidomos pas mbylljeve të gjata të pandemisë.
Ë kështu që buxheti për plan për implementimin e planit për siguri në shkolla ë do të jetë diku rreth tetëdhjetë mijë euro, i cili është i kombinuar në Dreë kemi planifiku edhe programi jashtëkurrikular edhe trajnime të mësimdhënësve për herë të parë, edhe kjo është një risi ë të cilën mendoj që ia vlen të theksohet edhe të prezantohet para jush, me diku rreth pesëdhjetë mijë euro për herë të parë do të bëjmë trajnime, do të organizojmë trajnime serioze për mësimdhënës që të punojmë shumë në ngritjen e cilësisë në arsim, dhe të mos të fokusohemi vetëm në infrastrukturë.
ë do të bëjmë pilotimin e mësimit gjëditor, i cili gjithashtu është i buxhetuar në këtë ë kategori, ë si dhe ë do të punojmë që të krijojmë ë Lounge Boxes ose ë kutitë e ushqimit për drekë për ë fëmijët e klasëve një deri më pesë, ë do të jetë një projekt gjithashtu i ri, të cilin ë e kemi pasë në plan të realizojmë ë qysh moti.
ë sa i përket ë shpenzimeve kapitale, kemi buxhetin diku rreth katër milionë euro.
Çka vlen të theksohet është që do të bëjmë ndërtimin e shkollës së re në lagjen Kalabria dhe kjo ka qenë kërkesë e kamotshme ë e asaj lagje që të ketë një shkollë shkollë fillore ë në atë pjesë.
Ë procesi i tenderimit për këtë shkollë tashmë veçse ka ka përfunduar dhe është në vlerësim dhe shumë shpejt do të shpallet shpresoj fituesi dhe pastaj fillojmë menjëherNjë tjetër projekt me rëndësi kapital është edhe Liceu artistik, i cili gjithashtu do të krijohet dhe do të ë fillojë ë ndërtimi në vitin e ardhshëm.
Ë çerdhe gjithashtu kemi aneksin e çerdhes Dielli, kjo ka dalë prej ë kërkesave të cilat i kanë bërë qytetarët në diskutimet publike në lagje, pra në Lagjen Bregu i Diellit, prandaj edhe i kemi reflektu në Buxhet.
ë si dhe ë ndërtimin në ndërtimin e çerdhes Lulevera, e cila është në një gjendje jo shumë të mirë.
Ë çka vlen të theksohet gjithashtu është që ë si vjet ne kemi fillu me pilotimin e mjeshtrit të shkollës, ë që ka qenë një ë premtim elektoralioni dhe vitin e ardhshëm do të fillojmë edhe me kopshtarin e shkollës.
Kështu që do t'i kemi dy projekte paralele me dy ndërmarrje publike,ndërmarrjen publike banesore, si dhe ndërmarrjen hortikultura, që mendoj që do të jenëprojekte të mira dhe me benefit për të gjithëkomunitetin arsimor.
Çka do që keni pyetje,jemi këtu të gatshëm për përgjigje.
Zilja është kohë.

**FOLËSI_08** **00:34**
Faleminderit!
Drejtorisht edhe a. Kërkoj ndjesë për zile.
gabim teknik, atëherë nëse kemi diskutime lidhje me me buxhetin nga Drejtoria e Arsimit, po hapim diskutimin.
Nëse nuk kemi, o po se kemi.
Po atëherë, lus regjinë të lutemi në ngritjen e duarve, për arsye se nuk po e shkojmë monitor.
Atëherë zonjës Kumrija Shabani më së pari.
Faleminderit!

**FOLËSI_10** **00:18**
Përshëndetje e nderuar drejtoreshë!
Ë dashta me ditë projekti për diçitalizimin ë që ka fillu, është një projekt që kemi pasë ne edhe në fushatë zgjedhore dhe po më intereson me ditë a ka me fillu nëpër të gjitha shkollat dhe a ka me u përfshi edhe shkollat nëpër fshatra.
Faleminderit!

**FOLËSI_08** **00:25**
ë atëherë drejtoreshë po ndërhy, po mendoj po i marrim pyetjet të gjitha pastaj vazhdojmë me radhë.
Regjia, të lutem, me ngritjen e dorës, vazhdojmë me po.

**FOLËSI_22** **02:02**
Përshëndetje kryesues!
Faleminderit!
Përshëndetje për të gjithë!
E dëgjova me vëmendje prezantimin e drejtoreshjes, por edhe kam lexuar buxhetin.
Kam një kërkesë edhe për kryetarin, por edhe për drejtoreshjen që te pika e katërt renovimi dhe mirëmbajtja e institucioneve edukativo-arsimore dhe rregullimi i oborreve dhe terreneve sportive është një shumë që ndahet prejnjë milion e treqind mijë dhe dyqind e pesëdhjetë mijë.
Ë bazuar në situatën e shkollave, të cilat janë dhe vizitat që i kemi bërë me disa asamblesit dhe diskutimet në Komitetin për Arsim, kam kërkesë që kjo shifër të rritet, sepse kemi një situatë jo të mirë në katër shkolla.
në ata: Hasan Prishtina, Ismail Qemali, Zenelë Hajdini dhe Nazim Gafurri, ë pastaj ndoshta është edhe Sami Frashëri, që të ndërhyhet urgjentisht në një renovim të thellë po e quaj dhe që është ndarja prej një milion e pesëqind mijë euro është e pamjaftueshme, kryetar.
Dhe mendoj që kjo shifër duhet të rritet.
Mund të dërgon edhe ekipe për të kontrolluar gjendjen.
E pastaj, pjesa tjetër që po e quaj si renovim sipërfaqësore mund të mbetet përshkolla të cilat janë në listë ose të cilat mund të evidentohet si shkolla që ka nevojë për intervenime ose renovime.
Ë Bazuar në ë të dhënat që kemi marrë nga terreni mund të ceki se ë dy shkolla, shkolla ë Zeni Hajdini dhe Nazim Gafurri janë shkolla të cilat mund të mendohet që edhe të ndërtohen tërësisht.
Janë shkolla të vjetra dhe kur kemi parasysh se sistemi arsimor ka ndërruarAndaj, edhe ndërtimi i ri i atyre shkollëve do të ishte shumë i mirë për mësimdhënësit, nxënësit dhe komunitetin se do të ndihmonte në ngritjen e mësimdhënies dhe mësimnxënies.
Nuk mund të them saktësisht që janë të dëmtuara dhe nuk mund të jenë si shkolla, mirëpo ka nevojë për ndërtim të ri në ato dy lokacione.
Faleminderit!

**FOLËSI_08** **00:11**
Faleminderit!
Ë vazhdojmë me kolegët me radhë.
me ngritje e duhurve, ashtu si regjia prej prej lartë she, zonjusha Fitnete Bejta.

**FOLËSI_13** **00:50**
Faleminderit, kryesues!
I nderuar kryetar, të nderuar kolegë, të nderuar drejtorë, nënkryetarë, ë përgëzoj drejtoreshën për qasje ndryshe.
Për herë të parë ë shkollat e Prishtinës kanë ë ndier dorën e pushtetit në renovim, në pastrim, domethënë kemi pasë këtu një notë të shkëlqyeshme kemi drejtoreshë.
Ë kam disa ë pyetje nga disa qytetarë ë të fshatrave, ku janë është vendosur m'u mbyll dy shkolla.
dhe kërkesa, përveçse unë si punëtor arsimit e përgëzoj këtë vendim, edhe pse është i vështirë, edhe pse ka risk në opinionin e gjerë, mirëpo vendimi më i rëndësishëm për të ardhmen e fëmijëve është.
Ë kërkesa është: çka do të ndodhë me objektet shkollore në ato zona, sepse ne e dimë që atje sigurim nuk

kanë dhe është a do të ketë një vendimmarrje të shpejtë që në mënyrë që të riorganizohen në një institucion tjetër, q

**FOLËSI_08** **00:08**
Faleminderit!
Ë nëse nuk kemi diskutim tjetër në lidhje me atëherë, po zoti Endrit Zabërxha.

**FOLËSI_23** **00:36**
Faleminderit kryesues!
Përshëndetje për të gjithë.
Ë në veçanti, pyetje për drejtoreshën është se çka konkretisht po parashihet për furnizimin me pajisje të atijve.
Ë e dimë që një prej pro premtimeve kryesore të ekipit të juaj ka qenë instalimi i smartbordave nëpër shkolla dheë apo parashihet që në këtë buxhet të përfshihen shkollat e Prishtinës dhe ato të tjerat me këto pajisje apo po flitet për pajisje tjera të teknologjisë, cilat janë ato?
Faleminderit!

**FOLËSI_08** **00:05**
Faleminderit zoti Zabërxha!
Atëherë drejtoreshë, ju lutem mund të përgjigjeni.
Faleminderit!

**FOLËSI_17** **02:59**
Okej, atëherë po shkojmë me radhë.
Ëë Kumri i saj i përketprojektit të digjitalizimit edhe ai përfshin të gjitha zonat pa dallim, patjetër.
Ë e mira e digjitalizimit është pikërisht kjo që është gjithëpërfshirës edhe të gjithëve ia jep mundësitë e njëjta, kështu që patjetër do t'i përfshijmë edhe shkollat në fshatra, edhe në zona urbane.
ë sa i përket pyetjes së dytë, ë për buxhetim për ë që buxheti për renovim të rritet, unë pajtohem plotësisht edhe me të drejtë ë Komiteti për Arsim i ka identifiku këto shkolla provë: shkolla Hasan Prishtina dhe shkolla Ismail Qemali që të dyja ë sivjet nuk i kemi renovuar për shkak që jemi duke e pritur një projekt nga Banka Gjermane e KFFS, e cila është në projekt në proces të prokurimit të renovimeve të këtyre dy shkollave.
ë tash me sa e kam kuptu, për shkak të sanksioneve që janë dhënë Qeverisë së Kosovës, për shkak që ky është projekt i Ministrisë së Ekonomisë, mund të ndodhë që këto dy ë renovime të dy shkollave gati se më të mëdhaja në Prishtinë ë të shtyhet, kështu që ndoshta është diçka që duhej me mendu me reagu të paktën në njërën prej shkollave, për shkak tëbuxhetit të ulët që e kemi këtu.
Sa i përket shkollave Zenel Hajdini dhe Nazim Gafuri është shumë e vërtetë, sidomos shkolla Zenel Hajdini ka nevojë për ë renovim të thellë edhe do ta bëjmë një vlerësim së pari të gjendjes nga profesionistët dhe pastaj të shohim se cilat janë hapat e radhës.Kështu që pajtohem plotësisht.
Ë Valbona paska shku, po e lus edhe unë që buxhetin këtu me na.
A është këtu?
Okej.
Val vonë!
Ndërsa sa i përket pyetjes së re të fitneteve, është pyetje shumë me vend.
Objektet shkollore, të cilat në vendet ku i kemi mbyllë shkollat, nuk i kemi lënë paraje.
Punëtorë teknikë po vazhdojnë me punu.
Nuk i kemi largu domethënë që me mbajtë pak a shumë të gjallë shkollën derisa të vendosim se çfarë do të bëjmë.
E kemi diskutu edhe me kryetarin që disa prej tyre t'i kthejmë në objekte kulturore për komunitetin.
ë tash na duhet veç një plan që t'i ë që t'i bëjmë funksionale ato.
Shkollat janë mbyllë me kërkesë të vetë prindërve, ë sepse me të vërtetë kanë qenë nga nëntë nxënës në shkollë dhe ka pasë klasë ku ë klasët e treta kanë mësu me klasën e pestë, me klasën e gjashtë dhe kjo ka qenë një problem shumë i madh.

Kështu që ne do ta bëjmë transportin e atyre nxënësve në shkolla të Prishtinës, përderisa ato objekte i kemi mbyllë sa i përket pyetjes së fundit e të drejtë, ë furnizimi me pajisje të IT-së, po kemi parapa edhe smart-bord, po edhe ë kabinetit të IT-së në përgjithësi.
Për smart-bord veçse e kemi ndarë një buxhet nga viti i kaluar dhe nga viti i kaluar që nga maji nëse nuk gaboj.
e kemi në proces tenderimit dhe kthehet vazhdimisht nga OSHP-ja.
Janë katërqind mijë euro vlerë të smartbordëve, të cilët nuk po mundemi me realizu për shkak të vonesave që janë në OSHP në lidhje me këtë proces.
Kështu që me atë furnizim do të vazhdojmë edhe për vitin e ri buxhetor.
Faleminderit shumë!

**FOLËSI_08** **00:08**
Faleminderit, drejtoresha Mus Murati!
Ë vazhdojmë me diskutimin me Drejtorinë e Mirëqeniesve.
Fjalën e ka drejtoresha Adelina Sahiti.

**FOLËSI_11** **02:38**
Faleminderit, kryesues!
Atëherë përshëndetje për kryetarin, nënkryetaren, nënkryetarin Zogaj dhe të gjithë juve kolegë të nderum dhe për juve të nderuar asamblistë.
Ë për neve si me thanë për Drejtorinë e Mirëqenies Sociale vazhdon të jetë në fokus dhe në prioritet ofrimi i shërbimeve sa më cilësore për të gjithë banorët e kryeqytetit dhe kësaj radhe këtu e kemi pasë fokusin kur them të e arsyetoj me buxhetin të cilin e posedojmë kur ne për neve me fokusin mpër kontraktimin e shërbimeve sociale, vazhdojnë të jenë subvencionet dhe ne prapë e kemi buxhetin e njëjti, kemi tetëqind mijë euro në subvencione, jemi duke shtuar në mënyrën më të mirë të mundshme me të gjitha kapacitetet që kemi shërbimet për qytetarët e Prishtinës, me fokus te gratë, me fokus te fëmijët, me fokus te personat me aftësi të kufizuar dhe vazhdojmë të jemi pranë qytetarëve të Prishtinës në këtë segment, e po ashtu edhe tek shërbku për herë të parë kemi ndarë shujtën për fam e ngrohtë për familje të skemës sociale, e cila gjithëherë ka shkuar me Drejtorinë e Arsimit, kësaj here e kemi buxhetuar në në Drejtorinë tonë që të jemi më që të jemi më më precizë në atë se çfarë duam të bëjmë dhe si duam ta ofrojmë këtë shërbim shumë të rëndësishëm për këto familje.
e po ashtu kemi kemi vendosur që për herë të parë të bëjmë një të të kemi një linjë të caktuar ku do të trajtojmë hulumtime ë të ndryshme sociale, të cilat pastaj do të na ofrojnë një pasqyrë të saktë dhe të plotë të gjendjes në territorin e e kryeqytetit, se cilat janë nevojat, cilat janë kërkesat dhe cilat janë dëshirat e e familjeve kosovare në aspektin social dhe ku ne duhet të intervenojmë si kryeqytet.
e tek shërbimet tek te kategoria e investimeve kapitale, e kemi sërish fokusin tek ndërtimi i Qendrës për Punë Sociale.
Më lejoni t'ju njoftoj të gjithëve që për herë të parë, pas shumë e shumë vitesh, kjo qendër do është dërguar në detyrë projektuese.
por shumë vitet që ka qenë në buxhet asnjëherë nuk ka shkuar deri në këtë fazë dhe ne jemi më se të lumtur që e kemi arritur këtu dhe e kemi për synim që ta bëjmë një qendër dinjitoze për ofruesit e shërbimeve sociale, për punëtorët tanë dhe pastaj qytetarët të kenë edhe vende dinjitoze ku të marrin shërbime.
Po ashtu, e kemi edhe Shtëpi për Mbrojtjen e Fëmijëve si grant qeveritar e ne vetëm këtë vit kemi vendosur vetëm si kryeqytet të japim dhe këtu një duke mos e ndalur dorën asnjëherë në shërbim të qytetarit.
Por, çkado qoftë, jemi këtu.
Faleminderit shumë për vëmendjen!

**FOLËSI_08** **00:17**
Faleminderit, drejtoreshë për informatat!
Nëse kemi ose keni dëshirë të diskutojmë ose diçka paqartësi lidhi me arsyeshmërinë që e dha drejtoresha.
Nëse jo, vazhdojmë me drejtorin, Drejtorisë Sportit, zotin Granit Rugova.

**FOLËSI_01** **01:12**

Faleminderit kryesues!
Përshëndetje të gjithëve!
Atëherë Drejtoria për Sport për këtë vit ka planifiku tre pikë katër milionë buxhet, i cili është dy herë më i madh se buxheti i këtij viti, prej saj dy pikë katërdhjetë e pesë milionë domethanë rreth shtatëdhjetë për qind e buxhetit shkon tek Arena Multifunksionale, i cili është projekti më i rëndësishëm jo vetëm i Drejtorisë, por edhe i Komunës edhe i gjithë vendit, i gjithë Kosovës.
Kryesisht projektet tjera janë: Vazhdimësi e projekteve ekzistuese të këtij viti si:vazhdimi i Tribunës së dy Korrikut, Ramiz Sadikut, ndërtimi i fitneseve të rejandërtimi i terrenit sportiv në Hajvali, i cili do të fillojë, besoj shumë shpejt në nga fillimi i mujit të ardhshëm, renovimi dhe mirëmbajtja e terreneve ekzistuese si në Dardani, Ulpiana, Qendër, Bregdjellit, Mat, Gërmi, Koliq, Besi edhe në vende të tjera, po ashtu do t'i ndërtojmë edhe dy fusha të reja në lagjen në Barilevë dhe në Qendër.
Pak a shumë, ky është buxheti për Drejtorinë e Sportit.
Nëse dikush ka ndonjë pyetje,

**FOLËSI_08** **00:06**
Faleminderit, drejtor Rugova!
Vazhdojmë diskutimin me zotin Sami Boroci.

**FOLËSI_26** **01:07**
Ë kryesues, faleminderit drejtor për prezantimin!
Kur pe marr fjalën, nuk po du me kalu pa të po e vlerësu punën që ne tu e bo vi prej Komunitetit të Sportit edheë po vazhdojmë me pasë prapë rol në kom në pjesën e Komunitetit të Sportit edhe po duk shumë veç me të falënderu për qasjen që e ke ë edhe që je tu qëndru afër klubeve, afër sportistëve edhe tu i kuptu nevojat e tyre.
Ë menoj që te pjesa e sportit do duhej të kishim buxhet hala më të madh, mirëpo ë qendra multifunksionale na e ka marrë buxhetin, po po besoj që edhe kjo do të do të jetësohet, do të realizohet.
edhe mandej do të jetë një një ambient ë mendoj shumë shumë i dobishëm për sportin në kryeqytet, sepse përveç lojëra mesdhetare e aktivitetit të ndryshme, do t'ju shërbej edhe klubeve këtu.
Mirëpo, për të ardhmen, unë besoj shumë që duhet me vazhdu rritjen e buxhetit në infrastrukturë sportive, sepse infrastruktura sportive vazhdon me qenë goxha keq në në kryeqytet, sepse Prishtina është ka shumë klube, ka shumë sportist dhe në këtë drejtim duhet me fokusu hala ma shumë.
Faleminderit shum!

**FOLËSI_08** **00:16**
Faleminderit kolegë për diskutimin!
Nëse kemi diskutime tjera në lidhje me sportin, jo atëherë, atëherë fjalën po ia dha zotit Krenar Xhaferi, drejtori nga të jashtësisshmërinë e projekteve.

**FOLËSI_25** **01:26**
Realisht, krahas projekteve të cilat i kemi ë vazhdu, që i bien në rruga A, ë unaza, qendër, tek lagj Arbëria,rruga Nekibe Kelmendi, ndarja zonale e qytetit, ë kolektori Naim Vali, kanalizimi në fshatrat e Prishtinës.
Të gjitha këto projekte do të vazhdojnë edhe vitin tjetër.
ë ne i kemi nda buxhetin edhe për projektet e reja, si: Nënkalimi në rrugën Agim Ramadani, Platforma ndërlidhëse Arbëri, Pallati i Rinisë, Sheshi Gjergj Bush e disa projekte të tjera.
Ë të gjitha këto projekte, ë një pjesë të madhe të tyre i kemi projektet.
Ë ë një pjesë e tyre, normalisht qëë mund t'i tenderojmë ë në momentin që hapet menjëherë ë buxheti, po ashtu edhe për pjesën e nënkalimit në rrugën Agim Ramadani, për platformën e Arbrisë, Pallati i Rinisë ë ë arkitekti i qytetit e ka marrë përsipër pjesën e projektimit që ne mos të kemi si me thënë atë ndekun e tenderimet ë në vitin ë që vijmë.
ë po ashtu edhe ë sheshi Gjergj Bush e ka fatin e njëjtë si këto projekte.
Unë kujtoj që të gjitha këto projekte ë sikur ë si vjet ë që kemi pasë ë një ë buxhet të tenderum në fillim të vitit dhe shumicën e atyre projekteve jemi duke i realizu edhe ky buxhet e pret po fati i njëjtë ë vitin tjetër.

**FOLËSI_08** **00:12**
Faleminderit, drejtor për informatat!
Hapim diskutimin.
Nëse jo, vazhdojmë nëse kemi atëherë, po vazhdojmë me zonjushën Donjeta Dragusha.

**FOLËSI_16** **00:44**
Faleminderit kryesues!
Të falënderoj drejtorin ë Krenarin për prezantimin e shkurt të Buxhetit për drejtorinë e tij.
Po ashtu po e shfrytëzoj rastin të falënderoj drejtorin për gatishmërinë e procedurave që shumicën e procedurave të nderuesepo tenton t'i kry paraprakisht, në mënyrë që mos të kemi vonesa në në procedura.
Unë kisha veç një pyetje për drejtorin.
Po e shohim këtë ndërtimin e ishullit që e lidh ishullit urban që e lidh Arberinë me Pallatin e Rinisë, një projekt shumë i mirëpritur, sepse ka kohë të gjatë që Arberia në Ilaxhi është shumë e afërt, po pat Meti si është shkëputur prej prej qendrës.
Ë drejtor, qysh është menu të të ndërtohet ky ishull dhe a ka naj naj ide të projektit

**FOLËSI_08** **00:04**
Faleminderit!
Ë atëherë, drejtor.

**FOLËSI_25** **01:02**
Ë realisht ë projekti i ndërlidhjes së Arbrisë me Pallatin e Rinisë është projekt që do të skicohet nga do të dizajnohet nga arkitekti i qytetit.
ë është ë pikërisht ë ë premtim i fushatës zgjedhore, i cili projekt ka qenë ë pak a shumë i dizajnum në konceptin e vet edhe gjatë fushatës zgjedhore, do të ketë po atë strukturë dhe do të ketë një ndërlidhje, pra lidhje të Lagjes Arberia me Pallatin e Rinisë.
Ë një lajm të mirë çka e kemi, e kemi nënshkru edhe tri ë ura të përkohshme të cilat do të lidhin Pallatin e Rinisë me pjesën eë ë Grandit, Hotel Grandit, po ashtu kalime nga ë Lagjja Arbëria si kalime të përkohshme ë te pjesa e Hekurudhës, po ashtu edhe te pjesa e Fakultetit të ë ë Fakultetit të Kimisë me pjesën e e Lakrishte me pjesën e e banesave aty.
Edhe këto tri janë ë si platforma ndërlidhëse me pjesët e lagjeve përreth.

**FOLËSI_08** **00:22**
Faleminderit!
Ë vazhdojmë.
Regjia, ju lus me ngritje dorës të jep fjalën ë qytetarëve.
Zoti Sami Salihu e ka fjalën.

**FOLËSI_06** **00:31**
Drejtorin, hajde faleminderit!
Faleminderit, kryesues!
Fillimisht dua t'i përgëzoj drejtorin dhe kryetarin për punën që janë duke e bërë.
Ë dhe ju falënderoj për mbajtjen e premtimeve me të cilat edhe e kemi fitu Prishtinën.
Mua çka më intereson është ndërtimi i nënkalimit Kalavri - Dardani, faza e parë.
Ë drejtor, çka do të bëhet me këtë fazën e parë konkretisht dhe në sa faza parashihet të jetë i gjithë projekti?
Faleminderit!

**FOLËSI_08** **00:13**
Drejtor, të shohim edhe të marrim ndonjë pyetje tjetër nga diskutimi dhe pastaj përgjigjeni.

Lus regjitje fjalën koleges.

**FOLËSI_15** **00:11**
Faleminderit!
Atëherë një pyetje për pikën tetë: Ndërtimi i tregjeve të gjelbërta.
Na intereson me ditë çfarë tregje do të jenë dhe çka është planifiku mu ndërtu atë.
Faleminderit!

**FOLËSI_08** **00:08**
Vazhdojmë, regjia.

**FOLËSI_10** **00:19**
Ë faleminderit, drejtor!
Faleminderit, kryetar!
E pashë që në këtë Buxhet është ndarë edhe një shumë për një për ndërtimin e objektit të ri të hortikulturës, ë po më intereson me ditë a keni mendu për lokacionin ku dhe kur ka me fillu përafërsisht.
Faleminderit!

**FOLËSI_08** **00:13**
Faleminderit!
Vazhdojmë me drejtorin Krenar Xhaferi.
Edhe një pyetje, paska pyetje edhe me tjerë, vazhdojmë me radhë.
Atëherë, regji lus të japë të gjithëve mundësinë.
Atëherë, vazhdojmë me Sami Borocin.

**FOLËSI_26** **00:54**
Faleminderit për prezantimin, drejtor!
Ë qysh për shijet ka me qenë buxheti e yt, ke me qenë ndoshta drejtori prej ma të ma të ngarkumeve, ë po e përmend edhe vetë, tash e ke arkitektin e qytetit edhe nuk mundesh me ardh me thanë në Kuvend, ma ë qysh kanë thënë edhe drejtorët paraprak, po qysh ka ndodhë ndoshta edhe vitin e kalum, ë mos me u re mos me u realizu ë buxhetit e pjesa e investimeve kapitale që është shumë e rëndësishme, mu realizu sepse veç kjo e transformon qytKonkretisht për t'ju mundalë pak te pjesa e unazes, po e shoh që është ndërtimi i unazes të qytetit segmenti lindje - jug - perëndim, Prishtina e Re.
Ë a mundesh veç me më tregu pak te pjesa e unazes, domethënë a është përcaktu ë kompomenej traseja edhe në çfarë faze a planifikohet mu kur me fillu dhe qysh ka me shku procesi i ndërtimit të unazes, kështu ma ma detaj është.
Faleminderit shumë!

**FOLËSI_08** **00:12**
Faleminderit!
Vazhdojmë mezotin Retkoceri.

**FOLËSI_03** **00:44**
Faleminderit!
Ë kryesues, ë Krenar, drejtor ë un gjatë, ë shikimit të buxhetit në ë drejtorinë tuaj, pe shoh që është një kategori e re për çka mendoj që edhe qytetarët duhet të jenë më të informuar, është një risi ë është intervenimi infrastrukturor në ndarje zonale në gjashtë zona.
në tërë territorin e Komunës së Prishtinës dhe është buxheti paraparë dy pikë pesë milionë euro.
A kishe mujt me na fol më shumë për të qysh është paramendu me u daqë kjo zona, po mendoj gjashtë zonat në në kryeqytet, çka përfshin edhe sa do të jetë fleksibile në realizimin e projektbuxhetit?

Faleminderit!

**FOLËSI_08** **00:04**
Faleminderit!
Vazhdojmë me radhë.
Profesori Raif Brofshori e ka fjalën.

**FOLËSI_21** **01:01**
Faleminderit, kryesues!
Përshëndetje kryetarë, nënkryetarë, drejtorë, asamblesë.
E falënderoj drejtorin për prezantim dhe për bashkëpunim veçanti, sepse e kemi pasë dy-tri herë takimi dhe i kemi analizuar bashkërisht edhe mundësitë për të investuar në infrastrukturën të gjithëmbëdhjetë të komunës.
Unë i kam vetëm dy pyetje ma konkretisht, drejtor.
Kjo të bëjë me investime në kodrin e trimave, a kemi për hir te qytetarëveme dhënë një shpjegim çka do të bëhet gjatë mu vitit dy mijë e njëzet e katër dhe kemi kanalizimin në fshatrat e Gollakut.
Është e përfshirë në tërësi.
A do të mendohet për të gjitha fshatrat dhe mos me pasë anashkalim?
A keni ndonjë specifikacion se ku dhe si do të bëhet?
A janë projektet e gatshme dhe kur pritet?
Atje kemi disa probleme në disa fshatra për të cilat kemi biseduar.
ma konkretisht për hir transparencës së paranzosur nëse keni mundësi të na i dhanë detajet.
Faleminderit!

**FOLËSI_08** **00:12**
Faleminderit!
Kolegë, vazhdojmë me diskutimet e radhës.
Nëse nuk jemi, atëherë drejtor, vazhdoni me përgjigje.
Faleminderit!

**FOLËSI_25** **10:36**
Realisht, kisha dashtë me potencu faktin që sa i përket buxhetit të vitit dy mijë e njëzet e dy dhe dy mijë e njëzet e tre, normalisht që ne jemi në realizim të atij buxheti dhe unë besoj që do të kemi një realizim jashtëzakonisht të mirë.
ë problemi ë sepse u ngrit këtu sa mund të tenderojmë ne sivjet, me një janari kemi procedu mund të them nëntëdhjetë për qind të projekteve për tenderim si Drejtori e Investimeve Kapitale dhe shumica e këtyre projekteve do të përmbyllen, përveç rrugës sa e cila normalisht do të vazhdojë, sepse është projekt tjetër kapital.
ë në propozimin tonë ë fillimisht ë kërkesat janë jashtëzakonisht të mëdha.
Ë flasim ë në fillim e kam dërgu një projekt-propozim mbi katërdhjetë e gjashtë milionë dhe është dashur të reduktohet, sepse buxheti është i tillë dhe ne duhet t'i ndajmë ë me mjetet që i kemi.
ë po filloj ë ë te pjesa e Ndërlidhjes Dardaninë me Kalabrinë.
Ë ideja ka qenë që ë vitin tjetër ta fillojmë këtë projekt të madh, duke pasë parasysh edhe ndërtimin e saj, por ë depërtimi i Veternikut me rrugën A.
e cila ë pas përfundimit të rrugës A, e cila është unë besoj që do të kemi sivjet asfaltimin e parë nga Veterniku deri te rruga ë rruga që çon për Pallatin e Drejtësisë, atëherë ne kur ta ndërhyjmë vitin tjetër depërtimin e rrugës A, atëherë do të krijojmë vështirësi në komunikacion.
Tash edhe depërtimi i rrugës A edheë nënkalimi Kalabri-Dardani do të krijon një situatë tjetër.
Po ashtu, e kemi parapa edhe ë nënkalimin të Agim Ramadani, e cila po ashtu do t'i ketë vështirësitë e veta sa i përket pjesës së komunikacionit.
Kështu që i kemi ruajt që mos ta bllokojmë situatën e komunikacionit, të punojmë t'i t'i orientojmë depërtimin e Vetnikut me rrugën A, duke i dhënë rrugëdrejt rruga në Ujësjellës, pra në anën tjetër do të ketë komunikim me rrugën B, pra do ta qetësojmë pjesën e komunikacionit për të ndërhy vitin tjetër me

projektin tjetër në nënkalimet ë Dardani - Kalabri.
Këto mjetet janë nda pak edhe për pjesën e dizajnit, por të njëjtën kohë janë nda që ta kemi mundësinë e tenderimit në ë fundin e vitit tjetër që procedurat e tenderimit t'i ndjekim në fillim të vitit ë ë që vjen, po.
ë ë te pjesa e unazës së ë qytetit ëI ideja është ne e dimë që kemi një ë një ë me BERZH-in e kemi një ë një mundësi ë kredie, e cila duhet të nënshkruhet nga niveli qendror edhe ë realisht kjo ë ë na penalizon ë ne si Komunë e Prishtinës, sepse duhet të ketë harmonizim.
Kjo pjesë e buxhetit do të mvaret shumë prej pjesës ë ecjes ë në vazhdim edhe dizajni është duke u punu.
Do del në diskutim publikë bashkë edhe me qytetarët edhe do të miratohet në Kuvendin Komunal.
Kjo është sa i përket ë pjesës.
Ndarja zonale e qytetit ë ndarja zonale e qytetit është një projekt që e kemi premtu në fushatën zgjedhore.
ë do të ketë ë tani jemi duke e implementu këtë projekt, janë gjashtë zona të cilat do të jenë gjashtë kompani në terren, të cilat në kohë reale do të bëjnë intervenimet emergjente në terren, si si mbylljen e gropave, si asfaltimet e shtresave qarkulluese, ë intervenimet në pjesën e tretuarve, intervenimet tjera ë sa i përket mobilisë urbane, pra do të kemi një një trajtim të përgjithshëm në kohë reale dhe në shpejtësië jashtëzakonisht mirë, kështu që është një ndër projektet kujtoj ma të mira të cilat i kemi ë krahas projekteve të mëdha të cilat jemi duke i punu.
Sa i përket ë ë ë investimeve në Kodren e Trimave, ne vetëm sivjet kemi fillu realisht një pjesë të projektit në Kodren e Trimave.
ë ë ë duke punu tani janë duke punu.
Në pjesën tjetër ë do të fillojmë shumë shpejt ë ë domethënë mbi një milion euro do të trajtohen vetëm sivjet në Kodren e Trimave, ndërsa në investimet që kemi parapa i kemi pa i kemi parapa për vitin tjetër disa rrugë të cilat ë nuk janë në gjendje të mirë.
Pra, sivjet do të investojmë në rrugët kryesore të Kodrës të Trimave t'i trajtojmë, ndërsa vitin tjetër do t'i trajtojmëë të trajtuar dhe ato normalisht ë do t'i bëjmë bashkë me bartësitë lokale, të cilat vetëm i kemi marrë ë si kërkesa.
Sa i përket investimeve në rrjetin e kanalizimit, ne i kemi të gjitha projektet të finalizume.
Ë e kemi lidhë një kontratë ë me një operator ekonomik, i cili vetëm e kemi ë aktive edhe normalisht që ne do të vazhdojmë.
Në krejt ë fshatrat e komunës së Prishtinës ka qenë edhe premtimelektoral i kryetarit Rama, që do t'i trajtojmë brenda ë dy vjetëve nga planifikimi jonë të gjitha trajtimet ë ë sa i përket rrjetit të kanalizimit në Komunën e Prishtinës.
Çka vlen të theksohet këtu, që nganjëherë kemi edhe vonesa në realizim të kontratave.
ë ne vetëm ë këtë javë i kemi shku tri kontrata, të cilat kontrata i kemi të rjek edhe garacionet bankare.
Para ë afër një muji i kemi shku edhe dy garacione bankare të cilat ë realisht nuk i kanë përmbyllë ë sipas kushteve të kontratës dhe jemi në inspektim të vazhdueshëm për secilën kontratë.
Pra, në momentin që tejkalohet afati, ne normalisht që do ta ë do ta ë do ta penalizojmë kompaninë, sepse ashtu e njeh edhe kontrata.
Ndërsa nëse ka vonesa në realizim të kontratave dhe nuk kemi operator i cili ë shkakton vonesa të panevojshme, atëherë ne do të vazhdojmë me shkurtje të tjera deri në një vetëdijesim të përgjithshëm.
Nuk ka ndodhë më herët.
ë në këtë pikë jemi të vendosur që nuk do të lojmë ë asnjë ë tolerancë sa i përket ë investimeve kapitale.
Pjesën tjetër ë ë tregu ëPo e përmend, po e përmenda që ë te tregu ë e kemi bo tre gjë realisht ë ë mobile, këtu kryetarin është ta ë kisha dashtë me me ndërhy te po te tregu ë te ë buxheti për tregun ë është ë ë investim i cili është propozu nga ë Kabineti, këtu kisha dashtë me ndërhy ë pjesa tjetër është kjo komplet ë e Drejtorisë së Investimeve.
zonat e përmenda në ndërkohë sa diskutova ë është i njëjti format sikur që jemi duke investu tani.
Pra, janë gjashtë kompani të cilat do të punojnë ë në gjashtë zona të qytetit.
Ë ë tani për shembull e kemi Lagjen Arbëria,është ë lagjja Shkabaj e ka një zonë, në të cilat jemi duke intervenu në të njëjtën kohë.
Sot isha në mëngjes te pjesa e Veternikut, pra në lagjen Prishtina e Re, e cila lidhet me pjesën e Lagjes e Mëshirë, në të cilën jemi duke intervenu në kohë reale.
Po ashtu, jemi në Dardani në qendër, është një zonë tjetër.
Pra, janë të ndame në lagje të caktume, të cilat do të intervenojnë në kohë reale sa i përket investimeve.
Sikur në investime në gropa, po ashtu do të ketë investime edhe në rrjetin e tretuarve, në ndërtimin e tretuarve, me investime në rrjetin e kanalizimit, nëse ka bllokada, investime të ndryshme të cilat do të lehtësojnë jetën e qytetarëve.
Më herët, ky investim ose ky intervenim është ba me ndërmarrjen publike banesore, e cila nuk ka qenë

funksionale, sepse ështedhe nuk kam rri me i trajtu të gjitha problemet të cilat janë në qytet.
Tani, sa po flasim ne këtu, janë mbi ë gjashtëmbëdhjetë ë punishte të hapuna sa i përket intervenimeve në gropa, të cilat janë duke intervenu në këtë moment sa poflasim ne çdo ditë i kemi këto intervenime, mbi dy javë i kemi intervenu mbi dhjetë mijë metra katrorë, që nuk ka qenë më herët, sepse mundësia nga një kompani me intervenu dhjetë mijë metra katrorë ka qenë e pamjaftueshme, ndërsa tash me gjashtë kompani jemi duke ndërhyrë në çdo cep të Prishtinës.
Çka mund të them këtu, ndarja zonale përfshin edhe fshatrat.
ë për shembull në Barilevë të Llumnicë e kemi një rrugë e cila mbi dhjetë vjet ka qenë jashtëzakonisht e dëmtume, në të cilën jemi duke punu.
Ë në rrugën Rimanisht - Besi janë duke punu në në këtë moment sa po flasim, janë duke mbyllë gropa duke trajtu me shtresa qarkulluese.
Në rrugë të Barilevës - Prugovcit janë vetëm duke punu tani.
Pra, kështu qëë jemi duke punu në të gjitha ë pikat edhe ndarja zonale është një ndër projektet ndoshta ma të mira që i qetëson qytetarët sa i përket problemeve të vogla me të cilat ballafaqohen ata.
ë Hortikultura e kemi nda një buxhet, ë ë realisht ë buxheti fillimisht ka qenë propozimi që të trajtojmë ë pjesën e e ë një objekti ku një roje rren në kushte shumë të vështira, në ndërkohë e kemi pasë idenë që ta trajtojmë një buxhet pak pak më të madh që tandër ta gjejmë një lokacion edhe ta ta trajtojmë.
Me arkitektin e qytetit e kemi mendu ë dizajnin, për me ë për pjesën tjetër që me vazhdu me një janar me i përcjellë të gjitha këto për tenderim.
Çka mund të them edhe diçka, që pjesën më të madhe të projekteve, tani sa po flasim, mbi pesëdhjetë për qind të projekteve i kemi vetëm projektet e përmbyllta, sa i përket dizajnit.
Ndërsa pjesën tjetër, në këto projektet e mëdhajatë kemi frontin ë e e tenderimit.
Ë kemi bisedu edhe me kryetarin Rama dhe me gjithë Kabinetin që projektet e mëdhaja, për shembull në Buxhet e kemi nën kalimin Agim Ramadani pjesë të Buxhetit edhe në vitin dy mijë e njëzet e dy, jemi duke tentu që ta di dizajnojmë dhe ta tenderojmë diku në fillim të nëntorit ta kemi tenderimin që mos të presimë dy-tre muj ose katër muj derisa të përzgjedhët kompania deri në fillim të punimeve.
Pra, në mars do të kemi mund të them ë ose gjatë marsit shumicën e këtyre projekteve duke u jetësu në Prishtinë.

**FOLËSI_08** **00:01**
Faleminderit, kryetari Rama!
Apo nënkryetare Sahatçiu, faleminderit!

**FOLËSI_00** **00:36**
Faleminderit shumë kryesues!
Shumë shkurt, vetëm për me plotësu pjesën e kësaj kontratës të re që është bë me investimet kapitale, për mbylljen e gropave dhe për sanimet e tjera, kemi jemi duke punuar aktualisht me e shtu mundësinë që përmes përfaqjes Prishtina online pik kome u bo raportimi direkt prej qytetarëve, ku do të ketë edhe informim për secilën zonë, me cilat lloje të sanimeve mund të bëhen, si një digjitalizim shtesë i këtij procesi që edhe na jep transparencë, por edhe na ndihmon që me menaxhu më mirë procesin e marrjes së kërkesave direkt nga qytetarët.
Faleminderit!

**FOLËSI_08** **00:03**
Faleminderit, nënkryetare!
Vazhdojmë me kolegun Muhamet Selmani.

**FOLËSI_12** **01:12**
Faleminderit kryesues!
Përshëndetje për të gjithëve!
Përshëndetje kryetarin, nënkryetarin, nënkryetar, drejtor.
E kam një pyetje, meqenëse drejtori i shërbimit publik janë në kusht, atëherë për kryetarin.
Kryetar, na vjet si vjet ke na pas dy herë vërshime prej lumit Llap.

Njëra prej tyre e ke qenë edhe tim vizitë dhe e ke pa konkretisht.
Në projekt buxhet po e shoh që janë veç njëqind e pesëdhjetë mijë euro për këtë projekt.
për të gjithë projektet, pastrimit të lumenjve dhe përroskave në Komunën e Prishtinës.
Unë besoj që është një urgjencë për intervenim jo veç lumi Llap, ne i kemi edhe në Kollak disa lumenj të vegjël edhe përroska që po bëjnë vërshime çdo vit.
Lumi Llap është më së keqi, për arsye se Komuna e Podujevës e ka bërë pastrimin e lumit Llap deri në hyrje të komunës apo konkretisht mes fshatit Lupshi dhe Barilevë.
Kjo nënkupton qëLëvizja e ujërave deri në këtë pikë është jashtëzakonisht e shpejt.
Unë kisha propozu që me pasë një zgjidhje dhe me këqyrë me një mënyrë se si do të bëhet intervenimi i kësaj UP-se, përndryshe do të kenë probleme sidomos që të pranvera dhe vjeshta janë të pashmangësh e vërshime.
Faleminderit!

**FOLËSI_08** **00:02**
Faleminderit kolegë!
Fjalën e merr kryetari Rama.

**FOLËSI_20** **02:28**
Faleminderit, zoti Selmani për pyetjen!
Unë e kam cek edhe ë tash hera e kalume që ishim atje në vizitë tek fshatrat që kanë vuajt faktikisht prej vërshimeve.
Është një situatë të cila ë na shfaqet si problem çdo vit, domethënë edhe kjo ka qenë me thanë me me dekada.
edhe i nevojitet një trajtim ë super serioz.
Pra, nuk është vetëm çështja e pastrimit të lumenjve, të cilin edhe jemi duke e bo faktikisht sot ë çdo ditë, atje nëpërmjet Drejtorisë së Shërbimeve Publike, ë mirëpo tash edhe me këto me gjashtëllotet që i kemi, pra edhe me to e kemi mundësinë tjetër shtesë për me i ndihmu Drejtorisë së Shërbimeve Publike, mirëpo paralelisht me ë kontratën e arkitektit të qytetit,një masterplan ë të tërë të lumit Llap që kalon prej krejt zonës që kalon prej ë pikës në Podujevë deri në anën tjetër ë për me trajtu pra për me dizajnu këtë hapësi dhe me trajtu një herë përgjithmonë që mos me pasë kësi probleme.
E dimë që ka këtu edhe ë ë ndërtime të cilat nuk ë ishte dashtë të jenë aty në zonën e vërshimeve, sepseë natyra e bën të vetën.
Pra, edhe kjo është një problem shtesë që duhet paralelisht me me trajtu.
Mirëpo, po them që ë përpos ë kontratave që i kemi për pastrime të lumenjve, jemi duke u marrë në mënyrën më serioze të një masterplani strategjik dhe një pro projekt-propozimi për trajtimin e gjithë lumit Llap.
Normal që kjo është ënë aspektin e përgjegjësisë është edhe e nivelit qendror, prandaj edhe kemi pasë edhe diskutime ë me nivelin qendror që të na ndihmojnë në këtë aspekt, në aspektin financiar, për arsye se ka me qenë një kosto ë e madhe, mirëpo nuk kemi mënyrë tjetër për me për mepër me e trajtu këtë aspekt, përveç po them ashtu me një masterplan, një analizë ë specialistëve të kësaj fushe për me e zgjidh problemin njëherë e përgjithmonë.
Edhe po them edhe ju lus edhe njëherë edhe qytetarëve, banorëve të asaj lagje që mos të ndërtojnë në këto zona, sepse janë në zona ë të vërshimit edhe njihen si tilla.
Pra, aty do do të kemi problem gjithmonë ë me vërshime.
Faleminderit!

**FOLËSI_08** **00:08**
Faleminderit, kryetar Rama!
Po e përmbyllim në diskutim nga Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit Kontrata me fjalën përmbyllëse nga drejtori Xhaferi.

**FOLËSI_25** **01:16**
ë realisht dashta vetëm me e plotësu nënkryetaren derisa të bëhet pjesa e platformës të ndarjes zonale, ë të

gjitha ë informatat i marrim prej ë vepfaqes Drejtorisë, ë dhe aty e procedojmë ë që kërkesat janë jashtëzakonisht të mëdha, ë po.
Domethënë ë realisht prej aty e procedojmë deri në një platformë të cilën jemi duke punuë po ashtu te pjesa e ë Barilevës, ë ë ne e kemi pasë një diskutim edhe me ë ë qeverinë sllovene, e të e cila ë ende nuk është përmbyllë.
Ë vullneti i tyre është që me investu në rrjetin e gropave septike komplet në pjesën e lumit Llap, i kemi vizitu në pjesën e Vran Idollit, e kemi ë vizitu edhe në pjesën e Barilevës, te Xhafollit, Drenovc, komplet atë segment.
ëë ideja është qënë buxhetin tonë të para parashohim një pjesë të buxhetit që ata të na bashkëngjiten me një investim tjetër që vullneti i tyre është jashtëzakonisht i madh.
Nësefitojmë edhe këtë, si me thënë, donacion, atëherë do të kemi një situatë shumë më të mirëatje në pjesën e Lumit Llap.

**FOLËSI_08** **00:05**
Faleminderit, drejtor!
Ë diskutimin e vazhdojmë me drejtorin e Bujqësisë, me drejtorin Plator Gërdovci.

**FOLËSI_04** **05:21**
Atëherë përshëndetje të përgjithë!
I nderuar kryetarë, nënkryetare, nënkryetarë, ë asamblesë, të nderum kolegë, ë po e filloj me ë shumën totale të buxhetit për vitin dy mijë e njëzet e katër.
Në total është dy milionë e dyqind e pesëdhjetë e pesë mijë euro.
Ë kryesisht një njëri prej investimeve kryesore është ë investimi kapital që do të bëhet në ndërtimin e thërtores së kryeqytetit.
Ë pra është edhe ëprojekti kryesor për të cilin janë bërë edhe studimi i fizibilitetit edhe janë marrë anketa të ndryshme edhe të grupeve të ndryshme të interesit dhe është kompletu si ë si komplet si projekt.
Ë pastaj ë në investime kapitale i kemi edhe ndërtimin e kopshteve urbane që i kemi një projektpo tentojmë përveç fshatrave ta sjellim pak bujqësinë edhe në brenda ë zonave urbane.
E kemi si pilot projekt, të cilin e kemi mendu ta realizojmë ë këtë vit, do të thotë në vitin dy mijë e njëzet e katër, të shohim të shohim çfarë impakti po ka, sepse e konsideroj shumë të rëndësishme ë që fëmijët tanë ë ta keni mundësi të dinë dinë më shumë edhe për bujqësinë.
ë tek subvencionet ë në total shumën për vitin dy mijë e njëzet e katër e kemi një pikë një milion euro, për dallim nga viti i kalum është njëqind mijë euro më pak.
Ë mendoj që është shuma optimale e mundshme ndoshta ëqë t'i mbështesë infermierët dhe nevojat e tyre.
Ë në total ë një pikë një milion të subvencioneve do të shfrytëzohen për mekanizëm bujqësor, arsyeja kryesore është ë edhe mungesa e fuqisë punëtore në fshatra dhe vjetërsimi i pajisjeve.
që të paktën t'ia lehtësojmë punën fermerëve tanë edhe normalisht që ë rendimentin e tyre ta tentojmë që ta rrisim ë vit pas viti.
Po ashtu, jemi komuna që e kemi gjetur me më së paku sera ë në Kosovë.
Mendoj që edhe serave do t'i kushtojmë prapë një prioritetdhe do ta rrisim numrin e e serave për dy arsye prapë: njëra është shtimi i rendimentit edhe po ashtu për shkak të kushteve shumë shpesh klimatike po kemi dëme në bujqësi dhe mendoj dhe konsideroj që ë me anë të serave lë të paktën rendimentin edhe i kemi më të lartë, po edhe ë produktet i kemi më të sigurta, po ashtu do do tentojmë që të ndajmë edhe pagesa direkte për sektorët që janë me rëndësi të veçantë për krye të shtetit.
ëë sa i përkrah të mallrat dhe shërbimet,normalisht që për ta mbyllur komplet ciklin që nga prodhimi e deri tek shitja e kemi mendu që për vitin e ardhshëm ta kemiedhe promovimin e produkteve bujqësore,ta kemi të paktën një vit ose njënjë vit kalendarik, ku kohë pas kohedo t'i kushtojmë rëndësi promovimit ëëPanaire dhe ë po normalisht do tentojmë që të bëjmë ndonjë platformë për shitjen online të produkteve bujqësore.
Ë e konsideroj që shufra kjo shifra është modeste, tridhjetë e pesë mijë euro, po të shohim ë vitin e ardhshëm se si do t'ia dalim.
Po ashtu, pikë me rëndësi shumë që e konsideroj për Drejtorinë e Bujqësisë është edhe Strategjia e Agroturizmit.
ë të gjithë ne e dimë, edhe posaçërisht ata që vijnë nga zonat rurale se çfarë kapacitete ka Komuna e Prishtinës ë për agroturizim dhe mendoj që nuk është mjaftueshëm e plotësume ë zhvillimi rural nëse ne si Komunë e kemi të zhvilluam agroturizmin.

kemi trashëgimi kulturore, kemi trashëgimi historike, kemi natyrë shumë shumë shumë të mirë që na e ka falë Zoti, prandaj këto tri elemente duhet t'i lidhim, po ashtu edhe infrastruktura në fshatra ë për ta zhvillu agroturizmin nuk është mendoj që është optimale, prandaj e konsideroj shumë shumë me rëndësi.
që vitin e ardhshëm ta kemi një strategji dhe të fillojmë ë të paktën me grantimin e disa prej shtëpive që janë boshatisë ose janë braktisë, t'i kthejmë në bujtina dhe t'i kthejmë në atraksion turistik ë për qytetarët e Prishtinës, por jo vetëm.
Përveç kësaj, ë te mallrat dhe shërbime e kena edhe mirëmbajtjen e tregut mobile.
Ne këtë vit e kemi renovu komplet tregun mobile, është i vetmi ë aktivitet që e promovon ë dhe u jep mundësi fermerëve tanë që t'i shesim produktetë po mendoj si kolektiv, prandaj ë është e nevojshme që ai treg të mirëmbahet, të renovohet gjatë gjithë kohës, që investimi jonë të mos shkojë dëm, sepse e keni parasysh që ai ë ai treg tri herë në javë del në lokacione të ndryshme dhe bartja e shtandeve normalisht që edhe mund t'i dëmtojë, pra duhet ta konsiderojmë edhe mirëmbajtjen.
Ë kaq sa i përket projekteve dhe buxhetit të Drejtorisë së Bujqësisë,Nëse keni ndonjë pyetje a sigjyrim, e lutem, urdhëroni!
Faleminderit shumë!

**FOLËSI_08** **00:05**
Faleminderit, drejtor!
Për informatat, ë vazhdojmë me kolegun Muhamet Selmani.

**FOLËSI_12** **01:16**
Faleminderit, kryesues!
Një pyetje drejtor.
Ë Me gjithë promovimin e mirë dhe punën që u ba pa dashtë me vendosë në rend të dytë, një kërkesë e kem diskutu që është viti i tretë radhi.
Ne nuk kemi pasë një plan ende përdepotë dhe frigoriferë për ruajtje në prodhime bujqësore, që është një ndër elemente shumë të rëndësishme të saj.
Unë me thanë që shumica e punës të fermerëve të komunës tonëose shfrytëzohen në komunat tjera ose shumë herë edhe shkon edhe dëm.
Unë të sugjeroj që edhe se kryetari i Komitetit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, ta marrim shumë me prioritet edhe për ju, kryetar, e njëjta kërkesë dhe vlenin, ta marrim shumë me prioritet një strategji për ndërtimin e këtyre deponimeve dhe filigrafere ku fermerët do t'i ruajnë ë prodhimet bujqësore.
edhe të dyshesin në një periudhë ma të volitshme, ose ndoshta edhe i konservojnë sezonat kur shiten.
Komuna e Prishtinës, duke e dijë saktësisht edhe këtë pyetje është për ty, drejtor, a e kena informatë?
A ka në Komunën e Prishtinës ndonjë deponi edhe frigorifer kur ruhen prodhimet bujqësore ose ku mund t'i deponojmë fermerët prodhimet bujqësore?
Faleminderit!

**FOLËSI_08** **00:03**
Faleminderit, koleg!
Vazhdojmë me kolegen Kumria Shabani.

**FOLËSI_10** **00:53**
ë faleminderit, drejtor Plator!
Të përgëzoj për punën që ke bë gjatë këtij viti ë me bujqit që gjithmonë ju ke qenë afër me subvencione, me pajisje bujqësore, po ë po më intereson me ditë për këtë vit sa ka me pasë subvencione për, e dimë që tash në vjeshtë ë bëhet edhe mbjellja e grurit edhe ë produkteve tjera.
Sa ka me pasë subvencione gjatë këtij viti ë për bujqit, ë se po e shoh që këtume një buxhet jo mjaft i këndshëm ë qysh kemi ia dalë dhe sa kemi pasë, meqenëse janë shumë të interesum bujqet me ditë, se nga ë Qeveria ë nuk kanë përfitu shumë subvencione për këtë vitin që lamë pas.
Faleminderit shumë!

**FOLËSI_08** **00:05**
Faleminderit!
Vazhdojmë me kolegun Fatmir Dervishi.

**FOLËSI_22** **00:49**
Faleminderit, kryesues!
Drejtor, të përgëzoj për punën.
Mirëpo te pika e dytë, ndërtimi i kopshtve bujqësore publike që është shtafur shkollës së mesur bujqësore, projekt fantastik që është për mu më i miri, mendoj që tetëdhjetë mijë euro janë shumë pak edhe pomendoj që drejtoresha e Financave dhe kryetarët duhet të mendojnë që të paktën ta bëjnë herët dy vlen njëqind e gjashtëdhjetë mijë dhe të zhvillohet në dy faza.
Është një projekt që me të vërtetë ia vlen të investohet.
Kemi shumë njerëz të cilët sot jetojnë vetëm për banesa të mbyllur dhe një projekt i tillë do të mundësonte që këta persona të lëvizin në kohë të caktuar nëpër këtë kopsht dhe do të ishte ve me të vërtetFaleminderit!

**FOLËSI_08** **00:08**
Faleminderit!
Atëherë, drejtor mundni me vazhdu me përgjigjet.

**FOLËSI_04** **03:32**
Atëherë, faleminderit!
Po, Muhamet, është e vërtetë që ë zonat rurale ose kryeqyteti ka mungesë të pikave grumbulluese.
Ne i kemi dy pika grumbulluese me frigorifer, po i quaj statik për ruajtjen e produkteve, po të dyjat janë për grumbullimin e mjetrave.
Pra, nëse e ke fjalën për perime, në realitet ne nuk i kemi ë asnjë.
Sa i përket ë se a duhet të jenë pikat grumbulluese, e kemi diskutu ë shumë.
Unë mendoj që një jo vetëm një pikë, po duhet të jenë disa pika ë rreth kryeqytetit që fermerëve tanë t'ju jepet mundësia për me me borxhin, por ju e dini ë koston e lartë se sa është realizohet një pikë grumbulluese dhe me për momentin me buxhetin që e kemi për vitin dy mijë e njëzet e katër e konsideroj ë të pamundur për me realizu.
ë kështu që të shpresojmë që të paktën vitin dy mijë e njëzet e pesë ta kemi një mundësi dhe ta realizojmë, sepse është e vërtetë që përveç grumbullimit, ë ruajtjes ë e krejt krejt kësaj ajo ndikon edhe pastaj edhe në ë edhe në prodhimin edhe rendimentin ma të lartë që ta kenë fermerët, sepse kur të kanë mundësinë për me e ruajtë ata kanë mundësinë me e shitë edhe në periudha të ndryshme.
Kështu që popajtona plotësisht që nevoja për pika grumbulluese me frigorifer është shumë e madhe.
Ë sa i përket subvencioneve me pagesa direkte ë zonja Kumrie, ë në vitin në në këtë vit ne nuk kemi mundësi të subvencionojmë grurin ashtu siç kemi bërë vitin e kalum.
ë edhe pse impakti i vitit të kalum në subvencionimin e grurit ka qenë ekstrem i lartë, sepse e kemi pasë shtim të sipërfaqeve të mbjellura për më shumë se tridhjetë për qind në territorin e komunës tonë.
ëë po këtë vit për shkak të mungesës edhe të financave nuk jemi mujtë me realizu se po jua kujtoj, ne e kemi pasë një kontratëpër projektin Siredqë çdo vitna i ka marrë peseqind mijë euro prej subvencioneve dhe realishtnë total krejt vitindy mijë e njëzet e tre ne e kemi funksionu me dy me afërsisht shtatëqind mijë euro.
ËëPër kopshtet urbane ë prof, pajtuna plotësisht, ë përveç përveç që mujm me ju dhani mundësi ë krejt po e lidhi idenë se çka është dhe çka kemi dashtë me bo, ndoshta s'ju marr shumë kohë, ë ne e dimë që shumë familje në Prishtinë nuk kanë tokë.
ë dhe dëshira e madhe, sidomos ë e familjarëve ose ë e personave që e kaloi një moshë për me ua dhënë një mundësi me e pasë kushtimisht një lehë të vogël për me e mbjellë dhe një kopsht të vogël për me ndaj me nipër mbesat, besoj që kish me qenë shumë e mirë për qytetarët e Prishtinës.
Jo të gjithë kanë fshat, jo të gjithë kanë mundësi me dalëë prej qytetit, prandaj e konsideroj ë shumë rëndësi dhe është pilot projekt.
Të shohim se qysh po ecë vitin vitin e parë, pastaj nëse ecë mirë ne e kemi idenë edhe me drejtoreshin e pronës, po edhe me edhe ë me nënkryetaren që këto pika pastaj gjejmë edhe toka tjera që kushtimisht po i quajt t'i rivitalizojmë ose t'i bëjmë të gjelbë të gjelbër të ashtu qysh qysh po dojmë.
Faleminderit shumë!

**FOLËSI_08** **00:06**
Faleminderit, kryetare!
Atëherë edhe një pyetje kolega Selmani.

**FOLËSI_12** **00:27**
Faleminderit, kryesues!
Nuk do të kryetar, Meqenëse buxheti i Drejtorisë së Bujqësisë për promovim dhe hartim strategjik është shumë i vogël, a kështu mujt me marrë si zotim që përmes ë arkitektit të qytetit me hulumtu pikat strategjike ku ne mund t'i ngresimkëto pikat e deponimit dhe frikoriferit për ruajtjen e perimeve dhe frutave të bujqve, pastaj me pa cila është metoda më e mirë dhe me gjetë metodën e financimit.

**FOLËSI_20** **01:33**
Po absolutisht si pjesë, ë për këtë arsye edhe është kontrata e arkitektit të qytetit që na mundëson me pasë intervenime të shpejta tilla, pra të analizave të mirëfillta të zonave të ndryshme nëpër fshatra, ku edhe mundësohet ndërtimi i depove.
ë këtë këtë aspekt mendoj që ë duhet me e ngritë ë së bashku edhe me fermerët, nëse duhet me bo një ashtu grup ë të përbashkët me ta, për me i shqyrtu pikat ë të preferuara pra prej tyre, sepse ata kanë mi përdorë ma së shumti.
Pra, nuk vjen vetëm nga ë aspekti ë profesionist i kontratës të arkitektit të qytetit, po edhe po them në diskutime me me me fermerët.
ë mendoj që do të ishte ndoshta ë me interes që të krijojmë një partneritet publiko-privat, domethënë mos të jetë ashtu ë vetëm publik apo e menaxhuar prej kryeqytetit a komunës administratës, mirëpo të jetë e menaxhuar nga sektori privat ë e ne nëpërmjet subvencioneve domethënë i përkrahim ëë fermerët që ë produktet e tyre me mujt me u plasu në treg atëherë kur edhe është më e vlefshme për ta.
Pra, duhet me mendu një një ë sistem më të mirëfilltë për ë zhvillim të tregut ë në zonat rurale dhe krijimin e këtyre deponimeve.

**FOLËSI_08** **00:05**
Faleminderit, kryetar!
Kam... Okej, vazhdo drejtor.

**FOLËSI_04** **01:09**
Tash me shtu, kryetar, diçka.
Realisht ne si Drejtori e Bujqësisë ë e kemi analizu komplet ë fshatrat dhe mundësi se kush e ka mundësinë që t'i ketë këto ë depo me frigorifer.
Domethënë ë është shumë e thjeshtë fshatrat rreth lumit Llap, ku prodhimtaria është shumë e lartë e kulturave bujqësore, normalisht që duhet të jetë një atje dhe tjetra duhet të jetë në fshatrat nga Llukari dhe Tutje.
ë në fshatrat ë që e ulëta po e konsideroj të Gullakut.
Domethënë, mjaftojnë dy pika me qenë, mjaftojnë ato dy pika ë edhe forma është se si duhet se si bëhet ne e kemi analizu, do të thotë mjaftojnë mjaftojnë që kriteret për grantimin e këtyre pikave grumbulluese të jenëtë qarta dhe të jenë në letër, po kryesorja është i kemi financat.
Do të thotë nëse i kemi mjetet, atëherë realizimin e dy pikave grumbulluese dhe formës se si duhet të funksionojnë ato ë është e mundur ë vetëm t'i kopjojmë le të paktën format se si janë bërë në të kalumen nga institucionet ë përgjegjëse.
Faleminderit shumë!

**FOLËSI_08** **00:37**
Drejtor, faleminderit!
Atëherë, kam një lutje për kolegët e të gjithëpranishëm.

Jemi duke diskutu buxhetin i cili është për vitin dy mijë e njëzet e katër, andaj edhe pyetjet le të jenë në fokus me pyetje specifike që do të bëjë me buxhetin edhe sigurisht se drejtorët ju janë për me dhënë arsyeshmërinë për ato pika të cilat kemi parqartësi.
Ë diskutime tjera lidhen me nevojën, sigurisht se komuna ka me pasë nevoja të ardhme, do t'i diskutojmë në takimet e radhëFaleminderit!
Kolega Jot Brajshori.

**FOLËSI_21** **00:10**
Faleminderit, kryesues!
Kam vetëm një pyetje për drejtorin.
A e keni planifiku e sa fermer do t'i mbështetni me mekanizëm bujqësor edhe sa me sera?
Kjo është pyetja ime.

**FOLËSI_08** **00:01**
Po, urdhëroni, drejtor!

**FOLËSI_04** **01:18**
Po, zakonisht ne ë fillimisht i hapim thirrjet dhe në bazë tëëë kërkesave që i kanë fermerët, pastaji i dërgojmë në prokurim përkontraktim.
Do të thotë gjithmonë thirrja është e para dhe se e shohim se sa është nevoja dhe sa i plotësojnë kushtet që t'i kenë ato pajisje dhe kush duhet, do të thotë në cilat zona t'i shpërndajmë, pastaj atokontraktohen nga operatori.
Pra, në të dy rastet ne asnjëherë nuk nuk vendosim shuma fikse, për shkak se na jep mundësinë edhe edhe ë kategoria e buxhetit ku ku shpenzohen, sepse subvencionet janë në total dhe ato në bazë të nevojave mund të shfrytëzohen.
Pra, gjithmonë së pari matetë kërkesa se sa është, pastaj ne edhe ndërhyjmë në ë në këto dy pika.
Unë e konsideroj shumë rëndësi të dyjat dhe mekanizmin edhe serrat, sepse ë ju që vini të paktën edhe që keni lidhje me fshatrat e dini se sa sa është zvogëlu numri i i i banorëve edhe ë duhet të jetë puna duhet të lehtësohet dhe këto dy forma janë format më të mira që edhe të kemi rendiment, po edhe puna të jetë më e lehtë.
Faleminderit shumë!

**FOLËSI_08** **00:10**
Faleminderit për informata, drejtor!
Atëherë diskutimin e vazhdojmë me drejtorin e Sigurisë, me Lulëzimin.

**FOLËSI_02** **05:45**
Ë faleminderit, kryesues!
I nderuar kryetar, të nderuar nënkryetarë, ë kolegë drejtorë, ë të nderuar asamblesit dhe qytetarë të kryeqytetit, ë faleminderit për mundësinë që të paraqes për herë të parë ë Buxhetin për Drejtorinë për Siguri dhe Emergjencia si drejtori e re.
që është krijuar këtë vit.
Ë Drejtoria për siguri dhe emergjencia për këtë vit ë ka për vitin dy mijë e njëzet e katër ka parapa një buxhet prej një milion e tetëqind e tetëdhjetë e katër mijë euro, i cili është ndarë në dy kategori kryesore, pra në kategorinë e ë shërbimit mallet dhe shërbime njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë.
një milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë mijë dhe për investime kapitale dyqind e njëzet e katër mijë euro.
Sa i përket projekteve në investime kapitale, ato janë të përqendruar edhe pse kërkesat kanë qenë jashtëzakonisht të mëdha, duke pasur parasysh një një rritje enorme të kryeqytetit në të gjitha anët dhe kërkesa që kanë ardhë edhe nga qytetarët, mirëpo edhe nga ë anëta edhe nga partnerët që ne bashkëpunojnë në baza ditore, ne jemi me përqendruar në në katër projekte ë nëpër investime kapitale: një ka të bëjë me ë pajisje me pompa zhytëse për Brigadën Profesionale të Zarfikësve, duke pasë parasysh numrin e madh të intervenimeve dhe numrin e madh po ashtu që kemi pasë edhe ë vërshimeve gjatë këtij viti në territorin e

kryeqytetit.
Ë që ë projekti tjetër ka të bëjë me rregullimin e dyerve të garazhove të Automated të Brigadës Profesionale të Zarfikësve.
ë dhe projekti i tjetër ka ë instalimi apo ndërtimi i shkallave emergjente në shkollat e kryeqytetit.
Gjatë këtij viti, Drejtoria për Siguri dhe Emergjencia në në bashkëpunim të ngushtë me Drejtorinë për Arsim ka bërë inspektimin e të gjitha shkollave të kryeqytetit dhe kemi kemi përgatitur raportet dhe kemi vërejtë se një pjesë e madhe të shkollave nuk kanë shkallë emergjente, e cila është e cila është parakusht për një siguri të nxënësve dheDhe po ashtu, ë ne e kemi parapa që në këtë nëpër vitin e ardhshëm të bëjmë blerjen e një cisteri për furnizim me ujë të pijshëm.
Duhet pasë parasysh që kryeqyteti nuk ka një një të tillë.
Brigada Profesionale e Zarfesë dhe cisterat që i ka, i ka për vetëm për pajisje për furnizim me ujë teknik, i cili nuk është ë i përshtatshëm për ujë të pijshëm, ndërsa ëKompania regjionale e Ujësjellësit Prishtina ë ka li ka të sasi të limituar të këtyre ë të sistemeve dhe bën furnizimin me ujë të pijshme në rast të nevojës edhe për komunat tjera të cilët janë pjesë e kësaj kompani, si kjo kompani mbulon dhe ne gjatë këtij viti kemi pasur kërkesa të jashtëzakonshme nga fshatrat e kryeqytetit ë për furnizim me ujë të pijshëm për shkak të ë num për shkak tëreduktimeve të mëdha që kanë ndodhë në në kryeqytet dhe në fshatrat e tilla dhe ne kemi pasë të arsyeshme si pasojë e kërkesave të qytetarëve që të pajisim me një ë me një ë me një cistern për furnizim me ujë të pijshëm.
Ndërsa i përket ë shërbimeve, ë Drejtoria për për Siguri dhe Emergjencia, për vitin dy mijë e njëzet e katër ë kemi paraparë edhe ë kontratë për intervenimeë riparimi dhe mirëmbajtje urgjente.
Ne vetëm duhet të kemi parasysh se deri tani kjo drejtori dhe duhet të falënderoj edhe publikisht drejtoritë tjera, situatë e investimeve si investimet kapitale, Drejtorinë për Shërbime Publike dhe drejtoritë tjera për mbështetjen që i kanë dhënë Drejtorisë për Siguri dhe Emergjencia në sanimin e ë ë sanimeve rasteve emergjente që kemi pasë gjatë gjatë këtij viti.
ë po ashtu ë kemi paraparë që të ndërtohet dhe të riparohet qendra për Qendra Operative Emergjente.
Për informatë tuaj, Qendra Operative Emergjente që funksionon në kuadër të Drejtorisë për Siguri dhe Emergjencia, e ka numrin që punon njëzet e katër orë dhe aty kemi edhe dy ë gjashtë operatorë dhe vetëm për këtë shtatë mujor kemi pranu mbi pesë mijë thirrjepër intervenime të ndryshme në kryeqytet, që të kanë të bëjnë me raste emergjence dhe raste intervenimeve që të të duardhurshme.
Po ashtu, ë është me rëndësi të theksohet se kemi parapa që kemi fillu dhe këtë vit do të vazhdojmë vitin tjetër.
ë instalimi i kamerave për kryeqytete, instalimi i kamerave të sigurisë, i cili është një projekt kapital dhe një një projekt që realisht i ka mungu kryeqytetit dhe si e tillë ka qenë nevojë e kohës dhe nevojë që kemi marrë kërkesë edhe nga Policia e Kosovës.
Ë dhe ky projekt do të vazhdojë do të fillon këtë vit, në vitin ardhshëm në vitin dy mijë e njëzet e pesë.
ë ndërsa projektet tjera që janë janë të cekë këtu është edhe për herë të parë do të krijohen edhe njësitë vullnetare të zjarrfikësve, që është e paraparë edhe me Ligjin për mbrojtje dhe shpëtim dhe çdo komunë është e para është e obliguar që të kryejnë edhe njësitë vullnetare për zjarrfikje dhe ne e kemi paraparë që edhe ë blerjen dhe fër dhe krijimin e këtyre ë njësitë e bë për vitin dy mij e njëzet e e katër.
ë po ashtu ë ë një prej ë një prej ë risive është ndihma që kemi fillu që kemi ë planifiku t'i dhemb Ligatës Profesional të Zarfikësve, e cila është realisht një prej shërbimeve që i ofrohet më së shumti qytetarëve të kryeqytetit.
që ë ndër ë pajisja me pajisje për nevojat e tyre dhe ë furnizimi me me ushqim për ë Brigadën Profesional të Zarfikësve.
Duhet të kemi parasysh se ne kemi mungesë të zarfikësve në kryeqytet, jemi duke punuar që të rrisim numrin eë zërfikësve profesionalë, mirëpo ë për momentin jemi në diskutime me në nivelin qendror, cila është duke na blloku rritjen e numrit të zërfikësve ë për kryeqytetin.
Më bes i hapur për pyetjet dhe komentet e jua.
Ju faleminderit edhe një herë dhe faleminderit për punën dhe angazhimin që drejtoritë, po edhe Asambleja e Kryeqytetit ka dhënë në përkrahjen për Drejtorinë e Sigurisë dhe Emergjencave.
Faleminderit!

**FOLËSI_08** **00:10**
Faleminderit, drejtor!
Atëherë po vazhdojmë diskutimin me kolegen Elmira Nikci.

**FOLËSI_15** **00:10**
Faleminderit!
Faleminderit, drejtor për shpjegimin!
Ë desha të ndërlidhem me pikën katër, ë sigurimi fizik i ndërtesave.
A mundesh me sqaru për çfarë ndërtesave bëhet fjalë?
Faleminderit!

**FOLËSI_08** **00:07**
Faleminderit!
Nëse kemi edhe pyetje tjera.
Nëse jo, pastaj vazhdojmë me drejtorin.

**FOLËSI_02** **00:21**
Po, faleminderit shumë!
Faleminderit ë e nderuar asamblistë!
Po ka të bëjë me sigurimin e ndërtesës ë ndërtesave të kryeqytetit, pra ndërtesës së komunës së vjetër, ndër komunës së re dhe objektive tjera që janë në pronësi të ë ë kryeqytetit.
Kjo është kompani private të sigurimit që është kontrata ekzistuese dhe do të vazhdojë për vitin tjetër.
Po, kjo ka qenë në kuadër të Drejtorisë së Administratës dhe është bartur në Drejtor

**FOLËSI_08** **00:08**
Faleminderit ë drejtor për informata dhe detaj.
Diskutimi do e vazhdojmë me Drejtorinë e Planifikimit, me drejtureshën Mimoza Sylemani.

**FOLËSI_18** **00:42**
Faleminderit, kryesues!
Përshëndetje për të gjithë!
Ë për vitin dy mijë e njëzet e katër, Drejtoria e Planifikimit Strategjik ka ë ka planifikuar të ketë nëntëqind e katërdhjetë e nëntë mijë ë euro, ku nëntëqind e njëzet e nëntë janë për arkitektin e qytetit dhe njëzet mijë janë për mirëmbajtjen e platformës GJI-së që tashmë e kemi marrë si platformë e re në Drejtorinë tonë.
në u përmendëm prej shumicës së drejtorëve që arkitekti i qytetit tashmë veç e ka filluar punën e vet dhe po shpresojmë që nuk do të kemi ngecje dhe prandaj e kemi edhe arkitektin e qytetit.
Nëse keni pyetje, unë jam këtu dhe po ashtu edhe kryetari për arkitektin e qytetit.
Faleminderit!

**FOLËSI_08** **00:04**
Faleminderit, drejtoreshë!
Diskutimi.
Ne vazhdojmë me kolegun Leutrim Retkoceri.

**FOLËSI_03** **00:27**
Faleminderit, kryesues!
Ë drejtoreshë Mimoza, Sa i përket projektit të arkitektit të qytetit, ë unë po e shoh që shuma është e ndarme, po ë çka na ka interesu si këshilltar komunal është, ka një listë të projekteve tashmë që është marrë arkitekti i qytetit, tu e marrë parasysh se është viti i dytë që është iu do buxhet këtij projekti.
Faleminderit!

**FOLËSI_08** **00:09**
Drejtoreshë, para përgjigje do i marrim edhe pyetje tjera dhe pastaj vazhdojmë diskutimin.

Ë vazhdojmë me kolegun Agron Canolli.

**FOLËSI_07** **00:45**
Faleminderit, kryesues!
Të nderuar kryetarë, nënkryetarë, drejtorë, kolegë asamblesit, e kam një pyetje për drejtoreshin Mimozë.
E nderuar duke pasë parasysh se në lagjet Kolovicë e vjetër, Kolovicë e re, lagjja Vneshta dhe lagjet përreth janë duke rritur mjaft mjaft numri i banorëvedhe besoj që është shumë e nevojshme ndërtimi i një bashkësie lokale, sepse besoj që do t'i ndihmonte jashtëzakonisht shumë banorët e këtyre zonave që t'i kryejnë shërbimet komunale në atë bashkësi lokale.
Ne e kemi diskutu edhe me grupin tonë të asambleseve, ku besoj që kjo kërkesë është drejtuar edhe tek ju, andaj kërkoj nga ju që të na jepni disa detaje se a ka mundësi të realizohet ky praprojekti.
Faleminderit!

**FOLËSI_08** **00:04**
Faleminderit kolegë!
Vazhdojmë me kolegun Ajet Braishori.

**FOLËSI_21** **00:33**
Faleminderit kryesues!
Kam një pyetje për drejtoreshën.
Të pasë parasysh gjendjen fizike tani në kodrin e trimave, në ndërtime të hershme dhe tani kemi një gjendje, unë them se për këtë plan të rregullativ, shumë keq.
A është menduar diçka keni punuar në këtë drejtim?
Ndoshta më shumë ka qenë pyetja për drejtorin e urbanizmit, por aty jeni bashkë të dytë.
sepse ka shumë qytetarë të cilët janë të interesuar me fillu edhe me ndërtime të larta dhe me ndryshuar edhe pamjen edhe situatën e atë pjesë të qytetit.
Kjo është pyetja.
Faleminderit!

**FOLËSI_08** **00:03**
Faleminderit!
Ë atëherë fjalën e ka drejtëresha Sylemani.

**FOLËSI_18** **01:48**
Faleminderit!
ëë Po Leutrim,ekziston lista se jemi tu punu edhe me buxhetin e dymijëenjëzet e tretës, me nënshkrimin e kontratës, e cila menaxhohet nga Drejtoria për Planifikimin Strategjik dhe Drejtoria e Urbanizmit, i cili ka edhe mbikëqyrësat e e e kësaj kontrate, me të marrëkontratën, ne ju kemi dërguar si drejtori të gjitha drejtorivenga një imejl dhe ju kemi kërku listëntë projekteve, të cilat ë i kanë dërgu.
Tashmë kemi takim të përjavshëm me arkitektin e qytetit, kryetari, gjithë kabineti dhe jemi duke punuar, siç e përmendi edhe drejtori i Investimeve Kapitale, drejtoresha e Mirëqenies, drejtoresha e Arsimit, mos t'i përmendi të gjithëMe radhë kështu që është lista, jemi tu e përpunu, çdo javë jemi tu u taku dhe ë buxheti i dymijëenjëzetenjërtës natyrisht që do të përfundon dhe të fillojmë edhe me dymijëenjëzetenjërtën, ë kjo ishte përgjigjja.
Kështu që lista ekziston dhe projektet të cilat kanë mbetur në gjysmë, qysh e ceku edhe drejtori i sportit, ë të gjitha ju kanë jep arkitektit të qytetit.
ë pyetja tjetër ke: Për bashkësinë lokale, ë po e diskutuam edhe me kryetarin.
Ë jemi në kërkim të lokacionit dhe ë Drejtoria e Planifikimit merret me planifikimin dhe projektimin, pastaj ë do do e dërgojmë njërën prej drejtorive për t'u bë edhe ndërtimi i bashkëcilës lokale.
Pyetja tjetër ke: Për Kodrin e Treva, edhe pse s'ka të bëjë me buxhetin, po për hir të korrektësisë po e përgjigjim.
ë ju e dini që ë është shpallur një një një kusht për masterplanin e zonës së Kodrës së Trimave, i cili është

duke u punuar.
Sot në orën pesë kemi veç takim bashkë me kryetarin dhe kabinetin dhe të shohim çfarë produkti kanë sjellë.
Kështu që me kohë ne do të dalim edhe në diskutim publik dhe do të marrim vesh edhe banorët.
Faleminderit!

**FOLËSI_08** **00:01**
Atëherë fjalën e pojava kryetarit Rama.

**FOLËSI_20** **02:01**
se mundem me u ndërlidh rreth ë masterplanit të rigjenerimit urban të zonës së Kodrës së Trimave.
Ë siç i përmendi drejtor Resha, po është vetëm në proces pra ky ë studim masterplan rigjenerimii cili trajton ë gjendjen ekzistuese tashmë, domethënë duhet me e ditë gjendjen ekzistuese, ë gjendja faktike në bazë të cilave masa ne edhe planifikojmë ë rigjenerimin e mirëfilltë të Kodrës së Trimave.
Në këtë proces jemi duke bërë një punë të madhe edhe në aspektin ligjor, domethënë e dimë që ë problemi kyq në zonën e Kodrës së Trimave, në shumicën e rasteve është pronësia.
ë edhe kjo ë po mundohemi tash, dhe nëpërmjet projektit të masterplanit të rigjenerimit dhe nëpërmjet ë analizave të pro pronës së ë Komunës së Prishtinës, pra tokave të ndryshme, që propozimi i masterplanit për rigjenerimme i zgjidhë jo vetëm aspektet urbane, pra mos me pasë vetëm propozime për zona të gjelbërta, krijimin e vlerës shoqërore, rrugë e tjera e tjera, po me e trajtu paralelisht edhe çështjen e pronësimit.
Një problem që kryeqyteti, kjo zonë e ka pasë qëkatërdhjetë-pesëdhjetë vite dhe kjo është ideja që ta zgjidhim jo vetëm aspektin urban, po edhe aspektin ligjor, në mënyrë që këto familje me mujt me i përdorë, me i kolateralizu ë banesat e veta për çështje të biznesit, të edukimit apo çfarëdo që kanë që kanë nevojë.
Pra, është një projekt shumë i madh që është duke u ba.
ë sot ë e kemi edhe një prej takimeve, sepse kemi pasë takime tjera.
Shumë shpejt, tash do ta organizojmë edhe diskutimin publik me ë qytetarët atje të Kodrës së Trimave ku edhe do t'i diskutojmë të gjitha të gjeturat dhe propozimet ë në në detal.
Faleminderit!

**FOLËSI_08** **00:05**
Faleminderit, kryetar Rama!
Diskutimin po e vazhdojmë me Drejtorinë e Kulturës, me drejtoreshën Arta Bali.

**FOLËSI_14** **03:49**
Faleminderit!
I nderuar kryesues, kryetar, ë asamblesit, kolegë, ju faleminderit për fjalën.
Sa i përket Drejtorisë së Kulturës, buxheti është si në vijim: ë investimet kapitale ë më në fund po jetësohet një projekt shumë i rëndësishëm për kryeqytetin, ë që ka të bëjë me Sallën Koncertale dhe Muzeun Bashkor të Artit.
Këtu janë ndarë dy milionë euro për vitin tjetër.
ne tami jemi në fazën e pritjes së projektit zbatues nga arkitekti i mirënjohur Kengo Kuma dhe po shpresoj që shumë shpejt do të bëhet edhe prezantimi përfundimtar i projektit të reviduar.
ë pjesa tjetër një dy milionë tjetër shkojnë për sa për revitalizimin dhe adaptimin e tulltorës.
Edhe ky është një projekt i cili ka filluar edhe këtë vit, mirëpo nuk po mund të finalizohet kjo pjesa e dizajnimit dhe po shpresojmë që sivjet do të kemi një një një plan projekt ideor dhe vitin tjetër do të vazhdojmë domethënë me pjesën e e revitalizimit dhe adaptimit të kësaj pjese, e cila do të jetë sidomos e rëndësishme përë artistët dhe për ë ë koncertet e përmasave më të vogla.
Edhe aty do të kemi pjesën e e sallës koncertale edhe një lloj galerie, mirëpo edhe pjesën të dedikuar për teknologji.
Ë renovimi dhe regjenerimi i pikës ikonike të kryeqytetit, edhe këtu po shpresoj që këtë vit do të fillojmë veç me punime në atë pjesë dhe vitin tjetër do të vazhdojnë punimet dhe është lënë një vlerë prej katërqind mijë eurove.

Këtë viti kemi pesëqind mijë euro për t'iu investuar, mirëpo ende nuk e kemi projektin zbatues dhe një njëqind mijë euro i kemi lanë për mirëmbajtjen e objekteve të institucioneve vartëse të të Drejtorisë së Kulturës, domethënë probleme të përditshme me të cilat ata hasen për çdo ditë.
sa i përket subvencionimeve ato kanë mbetë të njëjta, vlera e njëjtë, por shpresoj që vitin tjetër do të na gjejnë një rregullore e re për mënyrën se si do t'i shpërndajmë këto subvencione, sepse natyrisht edhe këtë vit, sikur çdo vit tjetër domethënë ka pakënaqësi, por shpresoj që kjo do të punojmë bashkërisht edhe me asamblistët që të krijojnë njëfarë rregullore të re, e cila do t'i kënaqë edhe më tepër domethënë institsa i përket mallrave dhe shërbimeve, e kemi vazhduar me pjesën e financave për dekorimin e qytetit.
Këtë vit kemi shtuar me kërkesë të asamblistëve edhe dekorimet për festa të rëndësishme, sepse e di që ka qenë kërkesë e këtij viti për festat të cilat janë të Bajramit, kështu që edhe këtu jemi munduar që të që të dëgjojmë edhe zërin e qytetarëve.
pastaj kemi ë ë kuratorin e organizimeve dhe ma manifestimeve kulturore, po mundohemi që të krijojmë njëfarë metode të re të organizimeve, jo sikurse që ka qenë deri më tani, domethënë nuk do të kontraktojmë kompani e cila do të kryer shërbime dhe ne do do t'i menaxhojmë, sepse kemi mungesë të stafit, por do të kemi kuratorë të secilit aktivitet kulturor dhe bashkërisht do t'i përcaktojmë se cilat janë prioritare për kryeqytetin, domethënë që të ketë ndoshtamë pak sa i përket sasisë, numrit të këtyre aktiviteteve kulturore, mirëpo të jenë të kuruara ashtu siç i takon kryeqytetit.
ËDhe pjesa tjetër, domethënë sikurse edhe viteve paraprake shkon për vlerjen e librave ë për Bibliotekën Hivzi Sylemani, vlera është pak më e vogël, mirëpo kanë mjaftueshëm ë ë libra dhe ë janë të pasura me libër.
Në fakt, mendojmë që ë në Kosovë është një prej bibliotekave të përgjyzuara më së miri.
Kështu që e kemi vlerësuar që vitin tjetër do të jetë vlera pak më e vogël, mirëpo që është e kënaqshme edhe për ta.
Ju falem

**FOLËSI_08** **00:11**
Faleminderit drejtoreshë për diskutimin dhe informatat!
Ë pasi që nuk ka pyetje tjera, po kemi kolegen Edrit Zabërxha, të lutem!

**FOLËSI_23** **02:48**
Faleminderit kryesues!
Faleminderit drejtoreshë për ë prezantimin e mirëfilltë!
Faleminderit po ashtu për punën dhe duke e di që je gjithmonë e qasshme nëkontributin e juaj.
Është lajm shumë i mirë që Prishtina në realitet dita-ditës edhe çdo vit po e rrit turizmin krahas vitit paraprak dhe pa dyshim se kjo është një meritë edhe e qeverisjes Rama, por edhe e Drejtorisë së Kulturës.
Po kemi shumë turista dhe në të njëjtën kohë po organizojmë shumë evente, mirëpo ku dua të vë theksin e veçantë është teknjë pikë që mendoj që është shumë shumë e rëndësishme në aspektin se çfarë ne po prezantojmë si kryeqytet në kuadër të historisë tonë kombëtare apo në bamendjes tonë kombëtare.
Është diskutuar në të kaluarën që do të krijohet edhe një muze për gjenocidin, nëse nuk gaboj.
duke pasur parasysh që pak a shumë ëEdhe ju drejtoreshë, po edhe ju kryetarë, Prishtina ka mungesë të objekteve të cilat në veçanti e dëshmojnë historinë e para njëzet viteve që e dëshmojnë gjenocidin për të cilin ka kaluar populli ynë.
Përveç artefakteve në Muzeun Kombëtar, nuk e di që kemi ndonjë pikë të veçantë ku të gjithë ata turistë që po vijnë në Prishtinë do të mund të shikonin se në çfarë ka kaluar Kosova, në çfarë ka kaluar populli jonë.
dhe pa dyshim se historia që harrohet ajo edhe mund të përsëritet.
Ë kam pritur që në këtë buxhet të jetë i përfshirë edhe ky muze, i cili do ta përkujtonte gjenocidin e shqiptarëve të përjetuar nga regjimi serb, andaj ëPo asgjë të keqe, vetëm dua të di arsyen se pse nuk e kemi tani dhe a jemi a kemi plane në mënyrë që ta ta transmetojnë historinë tonë të lavdishme përpara të gjithë këtyre turistëve që po vijnë.
Nëse i shohim kryeqytetet e shteteve përreth, sikur Shkupi, sikur të tjerat pak a shumë janë duke e bërë një investim të hatashëm, ndoshta edhe në prezantim të rrejshëm të historisë së tyre.
kurse e konsideroj që ne si shqiptarë kemi mjaft për të dhënë dhe mjaft për të dhënë, andaj cilat janë projektet dhe çka fshat po priten në në në këtë kontekst prej komunës tonë, duke e ditur se të gjithë këta turistë që po priten edhe do të rriten në vitin e ardhshëm me organizimin e festivaleve të tjera dhe eventeve kulturore.
Faleminderit paraprakisht!

**FOLËSI_08** **00:05**
Faleminderit koleg!
Po e vazhdojmë diskutimin me kolegen Arbënora Ajeti.

**FOLËSI_09** **00:19**
Faleminderit, kryesues!
Përshëndetje kryetarë, nënkryetarë, drejtorë dhe ju kolegë asamblistë!
Ë dua ta përgëzoj drejtorishëm për punën e mirë që është duke e bërë dhe një pyetje po ata: Cila është arsyeja pse nuk është në Buxhet Muzeu i Dhimbjes, pasi është një projekt shumë i rëndësishëm për historinë tonë?

**FOLËSI_08** **00:03**
Faleminderit!
Vazhdojmë me kolegun Amir Simnica.

**FOLËSI_24** **05:02**
ë faleminderit shumë!
I nderuar kryetar Rama, i nderuar nënkryetare Sahat Qiu, i nderuar nënkryetar Zogaj, të nderuar drejtorë të drejtorive dhe ju kolegë asambles, të nderuar qytetarë të kryeqytetit të Prishtinës.
E mora fjalën s'ka të bëjë me temën për ë drejtor ë Drejtoreshën e Kulturës, por dashta disa fjalë me i thanë sot rreth seancës më të rëndësishme që një Kuvendi Komunal i kryeqytetitqë është seanca e Buxhetit.
E sot jemi dëshmitarë të gjithë të punës së madhe që bëhet në kryeqytet, me një superkryetar, supernënkryetar, superdrejtora dhe kolegë asamblesit.
Zakonisht ë historia ndan dy grupeë në të gjitha sferat e jetës, ashtu edhe në politikë, sot kemi bo vijë ndarëse mes atyre të cilët janë pjesëmarrës në trenin e suksesit të kryeqytetit dhe atyre që kanë vendosur të mbesin jashtë dhe formën e tyre ta keqpërdorin besimin e qytetarëve të kryeqytetit, në këtë rast të Prishtinës.
Pavarësisht të gjithave, ne kemi qenëë e kemi përjetu një vdekje klinike tetëvjeçare në kryeqytet dhe na u desh që të vijë një arkitekt nga Londra me një super-ekip tash dhe të vi të vazhdojë dhe të fillojë punët e mira për kryeqytet.
Sot disanga kolegët tonë asamblistë, paskan vendosur të po i kujtojnë edhe seancën ku flitet për zhvillimin e hovshëm të Prishtinës.
Pavarësisht bindjeve politike, ne sot kemi vendosur t'u tregojmë qytetarëve të kryeqytetit që punët e mira në Prishtinë nuk ndalen me ose pa prezencën e tyre.
Ata të cilët formën e komunikimit e kanë zgjedhur nëpër rrjete sociale, sot kur është seanca ë më e vlefshme për këtë Kuvend Komunal, ata kanë vendosur që të mos marrin pjesë.
Përgjegjësia mbi e mbi ta, mbi ata qytetarë të cilët kanë vendosur që t'i votojnë zërin e tyre brenda Kuvendit Komunal,Ne sot kemi vendosur grupi tjetër i asamblaistëve prej njëzet e gjashtë asamblaistëve të marrim përsipër dhe të jemi pjesë e suksesit të hovshëm të Prishtinës me një buxhet për vitin dy mijë e njëzet e katër në një vlerë, e cila është mbi njëqind e njëzet e tre milion, domethënë kemi të bëjmë me një rritje prej njëzet milionë eurove prej buxhetit të vitit të kaluar.
E di kryetarë, nënkryetarë, drejtorë, kolegë asamblesit që jemi sot pjesëmarrës që pas votimit të këtij të buxhetit të kryeqytetit do të vërsulen përsëri ata të cilët e dinë më së miri këtë punë për rrjetet sociale të na sulmojnë, por ashtu siç nuk po mund ta ndalim punën e mirë që po ndodh në qytetin e Prishtinës e që jemi të gjithë dëshmitarë të asaj që nuk kalagje ose pjesë të qytetit që nuk ka filluar diçka të punohet, unë çuditem vetëm me një që thirren në emër të qytetit të Prishtinës e sot kanë vendosur që ta bojë që ta bojëkojtojnë zhvillimin e hovshëm për vitin dy mijë e njëzet e katër.
Çka kemi pa në buxhet të këtij viti?
Kemi pa ato të cilat kryetari Ramai ka folur gjatë fushatës gjithmonë edhe që qytetarët kanë filluar ta kërkojnë me të madhe projektet e mëdhaja për kryeqytetin.
Dy vitejanë investuar në lagje të cilat nuk është vërejt dora e pushtetit komunal për tetë vite kryetare.
Të jem falënderues për këtë.

Secila pjesë e qytetit e lagjeve të Prishtinës që kanë qenë në harresë të ish-pushtetitë sot vërehen punime intensive.
Dua t'i falënderoj të gjithë drejtorët për qasjen dhe informatën shumë pozitive në raport me ne asamblesit.
Janë të hapur për çdo pyetje dhe sugjerim.
Sot ë ky buxhet vjen me atë që në rregull qe dy vitekemi filluar, po punohet, por ne presim nga kryetari Rama projektet e mëdhaja të Prishtinës.

**FOLËSI_08** **00:03**
Regjia, nëse mund, ju lutem, një minutë!

**FOLËSI_24** **00:29**
Çuditërisht, ata të cilët kanë vendosur që sot mos marrin pjesë në seancë, në seancat e kaluara thoshin ku janë projektet e mëdhaja të përparimit.
Sot po flasim dhe kemi ardhë t'i votojmë ato projekte, e ata mungojnë.
Edhe një herë dua të falënderoj kryetarin, nënkryetarët, drejtorët, juve kolegë asamblistë, na priftë e mbara në projektet e mëdhaja të kryeqytetit.
Ju faleminderit shumë!

**FOLËSI_08** **00:21**
Faleminderit ë kolegë Simnica!
Po e vazhdoj diskutimin e mbetur.
me përgjigjet nga Drejtoria e Kulturës.
Fillimisht po vazhdojmë me kryetarin Rama.
Përgjigjet nga pjesa e Drejtorisë së Kulturës, Muzeu

**FOLËSI_20** **01:29**
apo faleminderit ë kryesues!
Unë vetëm desha me u ndërlidh me zotin Zabërxha rreth ë aspektit të muzeut.
Ë vetëm se e kemi këtë tash në në ë termat e referencës për një konkurs ndërkombëtar.
Ë lokacioni i saj ka me qenë në Prishtinën e re, pra Muzeu i Paqes.
Ashtu kemi vendosë me ia vu emrin, por normal.
Po mendoj është një prej propozimeve.
Mundemi me i diskutu këtë aspekt.
ë arsyeja pse Muzeu i Paqes, aty normal që tregohen krejt çka populli ynë ka hekë gjatë këtyre dekadave, mirëpo ideja është për me ia dhënë një konotacion pozitiv për për të ardhmen, pa marrë parasysh që ë është i dedikuar vuajtjeve të popullit tonë, heroizmave, herojve tanë ë e çdo ë nane e motre e e çdo pjesëtari faktikisht që ka kontribupër ne sot me e pasë fjalën e lirë dhe me gëzu demokracinë që e gëzojmë, lirinë që e gëzojmë sot së bashku.
Pra, ke plotësisht me drejtë, po po them që ai është në proces tash.
Po ashtu, kemi edhe disa pika tjera në kryeqytet që kanë ashtu konotacion të drejtpërdrejtë, ndërlidhur të drejtpërdrejtë me memorien shoqërore.
ë që po ia lo drejtoreshës me me me diskutu rreth këtyre pikave tjera.
Faleminderit!

**FOLËSI_08** **00:02**
Faleminderit, kryetar!
Diskutimi ne e vazhdojmë me drejtoreshin Arta.

**FOLËSI_14** **02:06**
kryetarëve në mënyrë kryesues, domethënë Entretë për ty ishte përgjigjja prej kryetari, ndërsa për Arbnoren desha me ju informu që përveç këtyre projekteve që i keni parë në buxhet të paraqitura, janë edhe disa

projekte tjera të cilat i kemi diskutu me kryetarin dhe nënkryetarin dhe është pajtuar që atotë trajtohen përmes arkitektit të qytetit dhe të tilla janë dizajnimi dhe ndërtimi i muzeut të dhimbjes ose deportimit.
Edhe kjo do të jetë domethënë pikë e diskutimit me opinionin publik se si do të emërtohet, por kërkesa është drejtuar tek kryetari dhe po dihet që lokacioni duhet të jetë te stacioni i trenit.
Domethënë, aty ku është bë deportiminë vitin njëmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë dhe që është një memorie jashtëzakonisht e dhimbshme për qytetarët e Prishtinës, sepse pas një kohe shumë të gjatë për herë të parë janë vu në Lëvizje trenat ë pikërisht për deportimin e e ë Prishtinasve jashtë territorit të Kosovës.
Kështu që këtë imejl me këto propozime i kam marrë drejtorisha ë Mimoza dhe po besoj që ë do të trajtohen me me seriozitet.
Gjithashtu, veç sa për informacion, veç t'i keni edhe disa projekte tjera të cilat janë dërgu dhe kryetari është zotu që do t'i përkrahë.
Do të jetë edhe revidimi i projektit të të shtëpive shkolla të hërticët.
ëë domethënë një projekt jashtëzakonisht i rëndësishëm.
Ekziston një projekt, mirëpo ai duhet të revidohet dhe kjo do të bëhet përmes arkitektit të qytetit,dizajnimi dhe rikonstruimi i objektit të Kinë-Rilnisë.
Edhe këto do të jenë paraprakisht do të përcillen edhe me debatet e opinionit publik, kështu që për të gjitha do të jenë të informum, por nuk janë në buxhet, sepse nuk ka pasur mjete të mjaftueshme, por kryetari e ka thënë që do të mireadaptimi i qendrës rekreative për fëmijë, qendra në Gërmi, edhe këtë e kemi diskutuar, që të shndërrohet në një qendër kulturo-sportive ë dhe ë ridizajnimi dhe adaptimi i degës së Hivzi Sylemanit, asaj që është në Tokë Bashi dhe te Pallati i Rinisë.
Kështu që për informacione të matutjeshme do të jemi në kontakt se si do të trajtohen këto përmes arkitektit.
Faleminderit!

**FOLËSI_08** **00:35**
Faleminderit, drejtoreshë!
Përfunduam me diskutimet rreth Buxhetit nga Drejtoria e Kulturës.
Andaj, ju lus pasi që jemi në përfundim të diskutim nëse kemi ndonjë parqartësi për drejtoritë tjera apo në përgjegjësi për Buxhetin me një pyetje specifike.
Nëse nuk jemi, atëherë lus edhe shërbimin e Kuvendit të shoh a kemi kuorum për të kaluar në votim.
Atëherë njëzet e gjashtë, jam prezent dhe po bëhemi gati.
Lus regjinë të jetë gati për votim.
Atëherë, votojmë.

**FOLËSI_23** **00:07**
Propozim, vendimin... Okej.

**FOLËSI_08** **00:03**
Atëherë, po e ndërprejmë dhe po i japim fjalën në leutrimin e Kocerit.

**FOLËSI_03** **02:58**
Kryesues, nuk kem nevojë me ndërprehe gjë.
Sot e di që ë ndoshta duket një ditë e gati, po besoj e kemi obligim për me përmbushë detyrën tonë si përfaqësues ë të Kuvendit Komunal edhe ekzekutivi para qytetarëve të ë kryeqytetit.
Ë unë e pata edhe një çështje që me ë drejtoreshin e financave e diskutuam në ë Komitetin për Politikë dhe Financa.
dhe ë dy projekte jashtëzakonisht të rëndësishme të kërkuara nga qytetarët dhe të dalura së fundit si ndër problematikat më të mëdha në qytet është ë çështja e ë grumbullimit të mbeturinave edhe çështja e transportit publik.
Ë me sa po e shohim, me buxhetin e vitit dy mijë e njëzet e katër, edhe pse kemi një rritje për ë transport publik,prej një milionë euro, nga pesë milionë euro në gjashtë milionë euro.
Ë në vitin dy mijë e njëzet e katër kur parashihet edhe të vijën flota e autobusëve të rinj edhe atyre elektrik

dhe inkorporimi i sektorit privat në transportin publik të qytetitA është kjo shumë e mjaftueshme për ta mbuluar në tërësi ë këtë shpenzim dhe nëse nuk është, atëherë ka do t'i marrim mjetet për ta mbuluar ë këtë pjesë, sepse ë siç jemi të informuar, ne dhe qytetarët, tashmë është edhe një marrëveshje në mes ë Bankës Botërore që obligon Komunën e Prishtinës qëkatërdhjetë e nëntë për qind të ë transportit publik të mbulohet nga operatorë privatë.
Kjo është një një pyetje, ndërsa pyetja e dytë ka të bëjë me çështjen e buxhetit për ë pastrimin apo grumbullimin e mbeturinave.
është një rritje prej për dallim prej vitit të kaluar, prej vitit dy mijë e njëzet e tre në vitin dy mijë e njëzet e katër, nga ë tre milionë euro në katër pikë tetë milionë euro, rritje prej një pikë tetë milion euro.
Mirëpo, nëse përpjesëtohet kjo, atëherë i bien që kjo rritje është rritje për ë gjashtëdhjetë e dy mijë klientë, nëse e llogarisim edhe rritjen e faturës për të cilën nga viti në vit deponia është duke rritë çmimin edërgimit të mbeturinave në deponi nga një euro secili vit, do të shkretë deri në tetë euro vitin e ardhshëm.
ËA e mbulon pjesën prej nëntëdhjetë e dy mijë klientëve kjo shumë për të cilën është bërë një regjistrim dhe ne e dimë e diskutuam si për grantin qeveritar që për momentin në Prishtinë shërbehet më shumë shërbim sesa që paguhet qoftë me grantin qeveritar apo me Buxhetin aktual.
Jam i interesuar që të dy çështjettë kem siguri se kemi mjete të mjaftueshme ë të disponueshme për këto dy projekte, mjaft të rëndësishme për kryeqytetin.
Faleminderit!

**FOLËSI_08** **00:09**
Faleminderit, zoti Retkoceri!
Atëherë fjalën po ia dha kryetari Rama.

**FOLËSI_20** **04:13**
Ë faleminderit, zoti Retkoceri!
Unë veç po ndërlidhem ndoshta menjëherë ë rreth aspektit të grumbullimit të mbeturinave dhe kostot tyre.
Pra, kemi një ngritje të ë të hyrave ë prej gjashtëdhjetë e dy mijë në nëntëdhjetë e dy mijë, mirëpo paralelisht e kemi edhe një mungesë të madhe të ë ky aspekti i bizneseve, domethanë kemi numër të madh të bizneseve që nuk janë të regjistruara, mirëpo marrin shërbime.
edhe kemi bo strategjinë së bashku me ë shefin ekzekutiv dhe me Drejtorinë e Shërbimeve Publike.
Tash ë dhe edhe nëpërmjet Rregullores të re, Rregullorja e re përcakton ë aspektin kohor të hudhjes së mbeturinave, e përcakton po ashtu nevojën që çdo bi biznes me qenë ë i regjistrum ë edhe me pagu për humbje për hudhje të mbeturinave.
ë paralelisht ë kemi tash ë sistemin e ri të kontenerëve ë ë me ë ashtu ë sensor ë që i mundëson ë edhe mënyrën e re, për shembull për ndërtesa të ndryshme që me pasë qasje vetëm banorët e jo me ardhë dikushsiç ndodh sot, për shembull kemi operatorë ndoshta privatë që ju marrin fare qytetarëve për shërbime të mbetjeve inerte, mirëpo i hudhin tek ë këto të amvisërisë.
Të gjitha këto nëpërmjet Rregullores së drejtash kanë me qenë të kontrollume, të monitorume edhe do t'i ndëshkojmë të gjithë ëë pjesëtarët që janë të papërgjegjshëm, ë dhe mendoj që si rezultat i kësaj ë do të kemi një kontroll shumë më të mirë, shumë më efektiv dhe të hyra më të mira që me i mbulu ë nevojat e ndërmarrjes pastrimi dhe me pasë normal një shërbim ë shumë më shumë shumë më të mirë sesa që e kemi sot.
Pra, janë këto iniciativa që tash vetëm jam në proces, pra përveç edhe që përmendi edhe kamionëve e tri që do t'i kemi.
kontainereve shtesë, ë rregullores së re, ë pra ngritjes të buxhetit që kemi bo ë për këtë çështje.
Ë ndoshta para edhe po po ndërlidhem veç pak ë drejtoresh edhe në aspektin e transportit publik ëKemi tash strategjinë e digjitalizimit, pra të procesit të transportit publik dhe kemi një trend ë të të hyrave më të mëdha sesa ë në vitet e më parshme.
Ë si rezultat i kësaj, po them e kemi edhe përdorim më të madh të autobusëve me numrin shtesë të autobusave, me aspektin e digjitalizimit, gjithsesi se do të ngriten të hyrat dhe kjo ë parashihe që t'i mbulojë ë të gjitha ë nevojat.
ë normal që nëse ka ë po ky është një proces i ri dhe nëse ka nevojë që që ne t'i mbulojmë edhe ë aspektet tjera.
Pra, po them ky proces i krijimit të transportit urban si një, për momentin e kemi transportin urban ë kjo oferta publike dhe private.

mirëpo me kontratat e reja synojmë që edhe sektori privat ë të paguhet në anë të kilometrave jo ë jo me linja, pra ristrukturimi i të gjitha linjave, ë digjitalizimi i pagesës, ë edhe ë fuzimi i sektorit privat edhe publik ka me kriju një shërbim ë shumë ma të mirë tash për qytetarët nëpër edhe nëpër zonat urbane, edhe nëpër zonat rurale, e po ashtu edhe nëpër pjesë që sot nuk janë tëë që nuk shërbehen mirë, pra nëpërmjet edhe një ë thashë mundësie tjetër, nëpërmjet pesëdhjetë kombi i busave shtesë elektrikë që kanë me pasë qasje edhe nëpër zona ku autobusët sot, madhësia e tyre nuk i lejon me pasë qasje.
Pra, është kjo një një një strategji shtesë që ë ka me përmirësu edhe më shumë ë sistemin e trafikut urban. e po them edhe në aspektin financiar është është e planifikume dhe menaxhume, mirëpo ë drejtoresha gjithsesi që ë na jep edhe detale tjera shtesë nëse ke.

**FOLËSI_08** **00:07**
Faleminderit, kryetar Rama!
Fjalën e ka drejtoresha Albana.

**FOLËSI_19** **01:04**
Ë Leutrim, ashtu sigurinë që e kërkove për këto ndërmarrje publike, ndërmarrjet publike tona janë edhe vetëmenaxhueshme, kanë të hyra tjerajanë të shku mirë.
Ë kërkesat ë i dimë që i kenë edhe edhe drejtorët kanë paraqitë kërkesa faktike, të faktume që është shumë më e lartë.
Kërkesa vetëm për mallra dhe shërbime ka qenë katërdhjetë e katër milionë, por tavani buxhetor është njëzet e tetëdhjetë e dyqind.
me këto na do të menaxhojmë do të gjitha situatat të cilat na vijnë.
Duke parë trendin e mbledhjes së të hyrave vetanake, ku vetëm mujin e shtatë kemi me mbërri diku shtatëdhjetë e dy për qind, ne shpresojmë që do të kem tejkalim të hyrave dhe tejkalimi i çdo të hyre në bartje do të kalon në përmbushje të këtyre hendikeve të cilat janë të shumta.
Kjo është e vetmja mënyrë që na do ta menaxhojmë, por shpresoj edhe bashkëpunimet ndërmarrje do të jenë ato të cilat do ta mirënvajmë veten edhe për çka na nevojitet.
Ka ka shumë kontrata, ka shumë mundësi, kanë edhe të hyra tjera, kështu që besoj që do t'ia dalim së bashku.
Faleminderit shumë!